



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 33 Akti

Nr. 64 Vendimi

Tiranë, më 10.09.2018

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Lulzim Hamitaj
Brunilda Bekteshi
Olsi Komici

Kryesues
Relatore
Anëtar

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Denisa Kosta, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, në Tiranë, në datat 6 shtator 2018, ora 10:00, dhe 10 shtator 2018, ora 10:00, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:

Z. Bujar Hoti, prokuror pranë Prokurorisë së Apelit Durrës, përfaqësuar nga z. Julian Mërtiri, avokat i Dhomës së Avokatisë Tiranë, përfaqësuar me deklaram në seancë më datë 06.09.2018.

OBJEKTI:

Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE:

Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”;

Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoji arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Brunilda Bekteshi, subjektin e rivlerësimit dhe përfaqësuesin e tij, avokatin Julian Mërtiri, vëzhguesin ndërkombëtar; pasi shqyrtoi dhe bisedoi në tërësi çështjen që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit Bujar Hoti, i cili në seancën dëgjimore publike të datës 14.06.2018 kërkoi konfirmimin e tij në detyrë,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

Z. Bujar Hoti është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit të tij si prokuror pranë Prokurorisë së Apelit Durrës. Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar” dhe ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (më poshtë referuar si “Ligji nr. 84/2016”), parashikojnë se: *“Të gjithë gjyqtarët, duke përfshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, të gjithë prokurorët, duke përfshirë Prokurorin e Përgjithshëm, kryeinspektorin dhe inspektorët e tjerë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i nënshtrohen rivlerësimit ex officio”*.

Subjekti i rivlerësimit, duke qenë kandidat për anëtar në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, në bazë të nenit 279 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, u është nënshtruar procedurave të rivlerësimit me përparësi, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur më datë 30.11.2017, në përputhje me “Rregulloren për procedurat e zhvillimit të shortit” nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (më poshtë referuar si “Komisioni”).

Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga: 1) Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); 2) Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) dhe 3) Grupi i Punës në Prokurorinë e Përgjithshme.

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me vendimin nr. 1, datë 14.12.2017, të trupit gjykues nr. 3, pas studimit të raporteve të sipërpërmendura të vlerësimit, të hartuara nga institucionet shtetërore, vendosi: (i) të fillojë hetimin administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016 për të tria kriteret, bazuar në pikën 1 të nenit 4 të po këtij ligji, përkatësisht: vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës, si dhe vlerësimin e aftësive profesionale. Me mirëkuptim u caktua kryesuesi i trupit gjykues, z. Lulzim Hamitaj. Anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.

Më datë 09.08.2018, trupi gjykues, me anë të vendimit nr. 2, vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ kryesisht për subjektin e rivlerësimit, z. Bujar Hoti, bazuar në rezultatet e hetimit të paraqitura nga relatori i çështjes.

Më datë 13.08.2018, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 për të sjellë prova për të provuar të kundërtën, nëse disponon, brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit me postë elektronike; (iii) për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me

nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative, duke paraqitur kërkesë për njohjen me dosjen brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit me postë elektronike; (iv) përbërjen e trupit gjykues.

Më datë 27.08.2018, subjekti i rivlerësimit dërgoi shpjegimet dhe provat mbi rezultatet e hetimit kryesisht.

Më datë 31.08.2018, trupi gjykues, me anë të vendimit nr. 3, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, z. Bujar Hoti, në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016 dhe, me anë të postës elektronike, subjekti i rivlerësimit u njoftua se seanca dëgjimore do të zhvillohej më datë 06.09.2018, ora 10:00, në Pallatin e Kongreseve, Tiranë.

Më datë 06.09.2018 u zhvillua seanca dëgjimore, ku subjekti i rivlerësimit ishte prezent, bashkë me përfaqësuesin ligjor, z. Julian Mërtiri, avokat i Dhomës së Avokatisë Tiranë, përfaqësuar me deklaram në seancë më datë 06.09.2018.

II. SEANCA DËGJIMORE

Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, z. Bujar Hoti, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jabobs. Gjatë seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit, z. Bujar Hoti, shprehu qëndrimin e tij, duke parashtruar shpjegimet përkatëse lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit iu përgjigj pyetjeve të bëra nga trupi gjykues dhe vëzhguesi ndërkombëtar.

Subjekti i rivlerësimit depozitoi pranë Komisionit parashtrimet e tij, me shkrim, në lidhje me rezultatet e hetimit administrativ dhe dokumentacionin, pas kalimit të barrës së provës. Në përfundim të parashtrimeve dhe përgjigjeve të pyetjeve të bëra, subjekti i rivlerësimit, z. Bujar Hoti, kërkoi konfirmimin në detyrë.

Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Bujar Hoti. Trupi gjykues ndërpreu seancën dëgjimore të datës 06.09.2018, për të rifilluar më datë 10.09.2018 për shpalljen e vendimit.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Z. Bujar Hoti ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit ndaj tij, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ të zhvilluar ndaj tij.

IV. RIVLERËSIMI I PASURISË

Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

Deklarimi i subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur është dorëzuar në ILDKPKI më datë 25.01.2017, në zbatim të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. ILDKPKI-ja ka dërguar raportin e detajuar nr. (***) prot., datë 14.11.2017, lidhur me vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit sipas neneve 30 - 33 të ligjit nr. 84/2016, ku konstatohet se:

- deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- nuk ka kryer deklaram të rremë;

- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

Vlerësimi i pasurisë nga Komisioni

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit kreu një hetim administrativ të thelluar, i cili u bazua në: a) verifikimin dhe shqyrtimin e të dhënave të Deklaratës së Rivlerësimit Kalimtar (“Vetting”) të datës 25.01.2017 për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të; b) krahasimin e deklaratave të pasurive të dorëzuara në ILDKPKI për vitet 2003 -2016, në raport me të dhënat e Deklaratës së Rivlerësimit Kalimtar; c) shqyrtimin e të dhënave nga bankat, institucionet financiare dhe jofinanciare, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, organet tatimore, organet e tjera shtetërore, personat juridikë, individët, si dhe likuiditetet - gjendje *cash*; deklarimeve të marra nga të tretët gjatë hetimit administrativ; ç) hetimet e kryera lidhur me të dhënat e vetëdeklaruara nga subjekti i rivlerësimit kalimtar gjatë plotësimit të pyetësorëve të dërguar nga ana e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit d) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit, datë 27.08.2018, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, si dhe ato të paraqitura gjatë seancës dëgjimore;

PROCESI I RIVLERËSIMIT PËR KRITERIN E PASURISË I KOMISIONIT

Në deklaratën “Vetting”, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë deklaruar këto pasuri (të paluajtshme dhe të luajtshme):

I. Apartament banimi në Lagjen nr. (***) , Rr. “(***)”, Durrës, me sipërfaqe 157 m², me nr. (***) , sipas çertifikatës së pronësisë dhe kontratës së blerjes nr. (***) , datë 05.08.2005, nga firma ndërtuese “(***)”, në vlerën 3.000.000 lekë, karabina.

Burimi: Blerë me anë të kredisë së marrë nga “NBG Bank” sipas kontratës nr. (***) , datë 16.12.2004 (mobilim, punime të brendshme, pllaka, kompletim etj.). Vlera totale: 4.400.000 lekë. Pjesa takuese: 50 %.

Në bazë të kontratës nr. (***) , datë 24.04.2007, është blerë *de jure* shtesë e apartamentit të mësipërm me sipërfaqe prej 30 m², kundrejt çmimit 1.400.000 lekë; shtesë e cila *de facto* është blerë që në momentin e blerjes së apartamentit, po me kredinë.

Lidhur me këtë pasuri, ILDKPKI-ja ka konkluduar se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga ZVRPP-ja Durrës.

I.1 Faktet e konstatuara nga Komisioni, si dhe provat e administruara për vërtetimin e tyre gjatë hetimit administrativ

Pasuria apartament banimi, me sipërfaqe 157 m², rezultoi e përfituar me kontratën e sipërmarrjes nr(***) , datë 25.06.2004, e cila lidhej për një apartament banimi me sipërfaqe 157 m² dhe një garazh në pallatin që po ndërtonte shoqëria “(***)” sh.p.k., me çmim 70.000 euro, të cilat do të likuidoheshin sipas këtyre kësteve dhe intervaleve kohore: 1) 20.000 euro në datën e lidhjes së kontratës (datë 25.06.2004); 2) 40.000 euro më datë 30.06.2004; 3) 9.000 euro më datë 31.08.2004; dhe 4) 1.000 euro në datën e dorëzimit të sendit me procesverbal dorëzimi (sipas kontratës dorëzimi do të bëhej brenda datës 31.12.2004).

Nga verifikimi i dokumentacionit, kontrata e sipërmarrjes, datë 25.06.2004, e lidhur mes palëve, pagesat që rezultuan për këtë kontratë ishin:

- likuiduar 20.000 euro cash shoqërinë “(***)” sh.p.k. ditën e nënshkrimit të kontratës, sipas nenit 6.1 të kontratës së sipërmarrjes, ku palët kanë rënë dakord se: “Kësti i parë prej 20.000 eurosh paguhet në momentin e lidhjes së kësaj kontrate, e cila u likuidua në këtë zyrë noteriale para noteres”. Noteri publik, më datë 12.07.2018 konfirmoi vërtetësinë e

përmbajtjes së kësaj kontrate, përfshirë përmbajtjen e nenit 6 të saj, për sa i përkiste pagesës së kështit të parë prej 20.000 eurosh, burim i padeklaruar.

- likuiduar 40.000 euro në llogarinë bankare të shoqërisë “(***)” sh.p.k., burim i konfirmuar me anë të kontratës së kredisë nr. (***), datë 26.07.2004, me “NBG Bank”.
- likuiduar 8.000 euro në llogarinë bankare të shoqërisë “(***)” sh.p.k., burimi i konfirmuar sipas kontratës së kredisë shtesë nr. (***), datë 16.12.2004, me “NBG Bank”.

Lidhur me çmimin e paguar për këtë pasuri, në deklaratat periodike subjekti i rivlerësimit deklaron:

- Në deklarimin e pasurisë së vitit 2004 - *“Një kontratë sipërmarrjeje nr. (***)*, datë 25.06.2004, për shumën 70.000 euro, likuiduar 50.000 euro, si dhe faturat deri më datë 31.12.2004”.
- Në deklarimin e pasurisë së vitit 2005 - *“Shpenzuar 2.400.000 lekë për rregullimet e pjesëve të lëna karabina nga shoqëria e ndërtimit”*.

Komisioni konstatoi se pagesat e çmimit të blerjes sipas dokumentacionit për këtë pasuri nuk përputheshin me ato të deklaruara në deklaratat periodike dhe atë “Vetting”. Në momentin e nënshkrimit të kontratës, në vitin 2004, ishin paguar 20 mijë euro cash në prani të noteres, 40 mijë euro nga kredia e datës 26.07.2004 në “NBG Bank” dhe 8 mijë euro, po nga “NBG Bank” më 16.02.2004, total 68 mijë euro, nga ana tjetër, nuk rezultojnë kthime shume edhe pas deklaratës noteriale për pakësimin e objektit të kontratës së sipërmarrjes, me heqjen e garazhit. Në këto kushte, Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit të japë shpjegimet për çdo pagesë të kryer në lidhje me këtë apartament, të shoqëruar me dokumentacion provues, sipas ligjit, si për sipërmarrjen, ashtu edhe për shitblerjen, mënyrat e likuidimit të saj, gjendjen e pasurisë në momentin të cilin u mori në posedim, si dhe shpenzime të tjera të kryera për këtë apartament, përtej atyre që rezultuan nga dokumentacioni noterial dhe bankar.

Në vijim të kërkesës së Komisionit, subjekti i rivlerësimit deklaroi se në vitin 2003 - 2004 ka nënshkruar marrëveshje për sipërmarrje ndërtimi me shoqërinë “(***)” sh.p.k., ku vlera e blerjes (*pra, jo e sipërmarrjes*) ishte caktuar në shumën 50.000 euro, nga të cilat parapaguhet kapar në shumën 2.000 euro, në datën e nënshkrimit të marrëveshjes.

-Shoqëria “(***)” sh.p.k. zhvilloi punimet deri në vlerën 3.000.000 lekë dhe dorëzon objektin në gjendjen karabina.

-Me këtë rast nënshkruhet kontrata e shitblerjes së apartamentit nr. (***)

, datë 05.08.2005, për çmimin 3.000.000 lekë. Pagesa e këtij çmimi ishte realizuar nëpërmjet kalimit në llogarinë bankare të shoqërisë “(***)” sh.p.k. të shumës 40.000 euro, që buron nga kontrata e kredisë nr. (***), datë 26.07.2004 (*principal, 40.000 euro*) me “NBG Bank”.

-Në rrethanat e shpjeguara, nga shuma 40.000 euro, shoqëria “(***)” sh.p.k. ka zbritur shumën 3.000.000 lekë dhe, me diferencën, ka mbuluar vlerën e punimeve për përfundimin e apartamentit.

- Apartamenti u mor në dorëzim më datë 20.02.2004.

- Kostoja e ndërtimit të apartamentit në momentin e marrjes në dorëzim: 19108 lekë/ m², vlerë e cila ka dalë nga përlllogaritja sipas aktit të kontrollit dhe punimeve karabina, pranuar nga të dyja palët (3.000.000 lekë : sip. prej 157 m² = 19108 lekë); kostoja shtesë e kryerjes së punimeve nga subjekti i rivlerësimit, sipas situacionit të punimeve, ka qenë në vlerën 2.393.284 lekë, shumë e cila është mbuluar nga shuma e kredisë.

- Punimet për përfundimin e apartamentit prej 157 m² përfunduan në dhjetor 2004, kur u mor në dorëzim apartamenti nga ana e subjektit.

Referuar deklarimeve të subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, Komisioni konstatoi sërish mospërputhje për pagesat e çmimit të blerjes, sa u përket deklarimeve të tij në raport me dokumentacionin/transaksionet e kryera, pasi pranë Komisionit subjekti i rivlerësimit deklaroi se për apartamentin 157 m² kishte paguar në datën e nënshkrimit të kontratës 2.000 euro kapar, *cash*, dhe 40 mijë euro me bankë (*total 42 mijë euro*), ndërkohë nuk deklaroheshin pagesat 8 mijë euro me bankë dhe 20 mijë euro si pagesë e këstit të parë para noteres.

Lidhur me pagesën e çmimit të kësaj pasurie, në analizë të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe në vlerësim të dokumentacionit/transaksioneve bankare, Komisionit i rezultoi se:

Shpenzimet e deklaruara për shumën 3.000.000 lekë për kalim pronësie dhe 2.393.284 lekë për punime shtesë, pra totali 5.400.000 lekë, nuk pasqyronin vlerën reale të paguar për krijimin e pasurisë apartament banimi 157 m², për pasojë çmimi i blerjes së kësaj pasurie ishte fiktiv.

I.2 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

Subjekti i rivlerësimit, pasi u njoh me dosjen dhe me rezultatet e hetimit të Komisionit, në shpjegimet e tij, të paraqitura pas kalimit të barrës së provës, si dhe në seancën dëgjimore, ndër të tjera, ka parashtruar se:

Kushtet e kontratës së sipërmarrjes nr. (***) rep., nr. (***) kol., me vlerë totale 70.000 euro apartament + garazh, ku citohen dhe kushtet e likuidimit të shumave nuk janë respektuar, pasi: revokohet garazhi me vlerën 20.000 euro me anë të deklaratës noteriale me nr. (***) rep. nr. (***) kol., datë 11.08.2004. Nuk ka kryer pagesë para noteres në shumën 20.000 euro (*sipas vërtetimit të datës 20.07.2018 nga vetë noterja*).

Vlerat e paguara ndaj shoqërisë “(***)” sh.p.k. ishin: 2.000 euro *cash* parapagim, 40.000 euro kaluar me kontratën e kredisë nr. (***), datë 26.07.2004, me “NBG Bank”, dhe 8.000 euro kanë kaluar me kontratën shtesë të kredisë nr. (***), datë 16.12.2004, me “NBG Bank”, dhe rreth 600.000 lekë likuiduar *cash* deri në vitin 2006.

Apartamenti me sipërfaqe 157 m² ishte marrë në dorëzim në muajin gusht 2004 në fazën karabina, vetëm pasi kishte kaluar në llogarinë e shoqërisë “(***)” sh.p.k., që në datën 28.07.2004, vlera prej 40.000 eurosh, shumë e cila për të rakorduar me marrjen në dorëzim të apartamentit karabina dhe përfundimin e punimeve, kjo shumë i ishte dorëzuar nga ana e z. P. K., në të cilën e kishte depozituar *cash* më datë 29.07.2004, në vlerën 39 094 euro, dhe deri në dhjetor të 2004-ës realizohen punimet për përfundimin e apartamentit, sipas situacioneve të punimeve me vlerë 2.400.000 lekë.

Mospërputhjet midis deklaramit të kësaj pasurie në deklaratat vjetore 2004, 2005, 2006, 2007 dhe deklaramit në deklaratën “Vetting”, kishin ardhur si pasojë e faktit që punimet ishin kryer në vitin 2004, dokumentacioni kishte vazhduar në 2005-ën deri në vitin 2007 (sipërfaqja shtesë 30 m²), ndërsa likuidimet ishin mbyllur në vitet 2006 - 2007.

Vlera totale e likuiduar për apartamentin e banimit me sip. 157 m² ishte 5.400.000 lekë, ndërsa blerja totale nga shoqëria “(***)” sh.p.k. është 3.000.000 + 2.400.000 lekë. Vlera e sipërfaqes shtesë 30 m² është 1.400.000 lekë. Në total, në vlerë financiare pasuria kishte kushtuar 6.800.000 lekë.

I.3 Arsyetimi ligjor në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

Mbi çmimin e deklaruar të blerjes në deklaratën “Vetting”, apartament banimi me një sipërfaqe 157 m², në vlerën 3.000.000 lekë, karabina.

Trupi gjykues, lidhur me çmimin e blerjes së kësaj pasurie, në analizë të pretendimeve të ngritura në parashtrësë, pas kalimit të barrës provës, por edhe në seancën dëgjimore, vlerëson se:

-Provat e paraqitura¹ nga subjekti i rivlerësimit rezultojnë të njëjta me ato të dërguara gjatë hetimit administrativ, për pasojë nuk rezulton asnjë provë që të vërtetojë të kundërtën e situatës së paraqitur sa më sipër. Por, si në parashtrimet pas kalimit të provës, edhe në seancën dëgjimore, subjekti dha shpjegime dhe pranoi se çmimi i kontratës së shitblerjes nuk është shuma që ai ka paguar realisht për këtë pasuri, duke pohuar se vlera totale e apartamentit nuk është 3.000.000 lekë, por 5.400.000 lekë, vlerë e cila nuk përputhet me vlerën e çmimit të blerjes, deklaruar në deklaratën “Vetting”. Ky deklarim bie në kundërshtim me nenin 32, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, për deklarimin e pasurive, sipas të cilit: “Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, së bashku me deklaratën e pasurisë, paraqesin të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive”.

Trupi gjykues, në bazë të verifikimit të dokumentacionit të kësaj pasurie, administruar në dosje, në respektim të nenit 50, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit: “Komisioni, Kolegji i Apelit dhe vëzhguesit ndërkombëtarë bashkëpunojnë me organet shtetërore, personat fizikë dhe juridikë, vendës ose të huaj, për të verifikuar vërtetësinë dhe saktësinë e deklarimeve të bëra nga subjektet e rivlerësimit”, çmon se rezulton e mbështetur në prova se ky apartament:

a) është porositur në vitin 2004 në shumën 70.000 euro, me kontratën e sipërmarrjes nr. (***), datë 25.06.2004, me shoqërinë “(***)” sh.p.k., marrë në dorëzim në dhjetor të këtij viti, pasi ishin kryer punimet për ta bërë atë të banueshëm;

b) fillimisht për të janë likuiduar 20.000 euro cash, sipas nenit 6.1 të kontratës së porosisë me shoqërinë “(***)” sh.p.k. në ditën e nënshkrimit të kontratës, burim i padeklaruar nga ana e subjektit të rivlerësimit. Vërtetësia e përmbajtjes së kontratës së sipërmarrjes, përfshirë nenin 6 të saj, për sa i përket pagesës së kështit të parë prej 20.000 eurosh, mbështetet në deklarimin e noterit publik, me iniciale A.SH., datë 12.07.2018;

c) në vijim janë likuiduar 40.000 euro në llogarinë bankare të shoqërisë “(***)” sh.p.k., datë 26.07.2004, me “NBG Bank”;

ç) në fund, për këtë pasuri janë likuiduar edhe 8.000 euro në llogarinë bankare të shoqërisë “(***)” sh.p.k., më datë 16.12.2004 me “NBG Bank”;

d) ka kaluar në pronësi të subjektit *ipso jure* me kontratën e shitblerjes nr. (***), datë 05.08.2005.

Sikurse rezulton nga sa më sipër, pagesat për këtë pasuri janë kryer në vitin 2004. Një fakt i tillë gjen mbështetje edhe në deklarimin e subjektit në deklaratën periodike të vitit 2004, ku ka deklaruar: “Kontratë sipërmarrjeje nr. (***), datë 25.06.2004, për shumën 70.000 euro, likuiduar 50.000 euro, si dhe faturat deri më datë 31.12.2004”.

Trupi gjykues çmon se pretendimi i subjektit, se objekti është marrë në dorëzim në gjendje karabina në vitin 2004, nuk qëndron, pasi nuk përputhet me deklarimin e tij të dhënë gjatë hetimit administrativ se: “Në shkurt të vitit 2004 është bërë një verifikim i apartamentit në

¹Kontratë shitjeje nr. (***), rep., nr. (***), kol., datë 05.08.2005;

Akt kontrolli nr. 4 “Për përfundimin e karabinasë”, situacion i punimeve; deklaratë noteriale nr. (***), rep., nr. (***), kol., datë 20.07.2018; deklaratë noteriale nr. (***), rep., nr. (***), kol., datë 11.08.2004; kontratë sipërmarrjeje datë 25.06.2004; vërtetim i noterit publike A. Sh., datë 20.07.2018; kontratë kredie nr. (***), kol., datë 26.07.2004; certifikatë e pronësisë datë 08.08.2005.

fazën karabina dhe është përcaktuar një preventiv punimesh, të cilat përfunduan në dhjetor të vitit 2004, periudhë në të cilën merret apartamenti në dorëzim i përfunduar". Gjithashtu, në kontratën e shitblerjes, datë 05.08.2005, nuk ka asnjë parashikim kontraktor që ky apartament dorëzohet karabina, apo përcaktimin e ndonjë të mete mbi sendin/apartamentin. Shoqëria ndërtuese "(***)" ka lejen e shfrytëzimit, që miratohet nga Bashkia Durrës, e cila në datën 31.01.2005 ka konstatuar se punimet në këtë pallat kanë përfunduar tërësisht dhe, rrjedhimisht, për këtë shkak është kryer kolaudimi i godinës dhe, në vijim, kanë vijuar procedurat administrative për regjistrimin e pallatit në ZVRPP. Pra, godina shërben për qëllimin për të cilin është ngritur, apartamentet janë tërësisht të përfunduara, të banueshme dhe funksionale.

Nga ana tjetër, referimi i gjendjes së apartamentit karabina, në muajin shkurt të vitit 2004, nuk krijon asnjë ndryshim në skenarin e zhvillimit të veprimeve mes palëve kontraktuese, për vetë faktin se: subjekti i rivlerësimit, në muajin shkurt 2004 (*muaji kur bëhet verifikimi i deklaruar nga subjekti*) nuk kishte asnjë interes të deklaruar dhe asnjë marrëdhënie juridike me shoqërinë ndërtuese dhe investitore "(***)" sh.p.k. Sikurse rezultojnë e faktuar nga dokumentacioni shkresor, kontrata e sipërmarrjes për ambientet ndërtimore të pallatit (*ambiente që i përkasin një leje ndërtimi me subjekt ndërtues dhe investitor të përcaktuar*) mban datën 25 qershor 2004, pra 4 muaj më pas, kohë në të cilën mendohet që apartamenti ka qenë në fazë ndërtimi, por ende i paporositur nga subjekti, i cili e merr në dorëzim të përfunduar vetëm në muajin dhjetor të po këtij viti, muaj në të cilin subjekti kishte paguar për këtë pasuri shumën 68.000 euro.

Marrja në dorëzim e një sipërfaqeje ndërtimore me destinacion banimi, por e pabanueshme, nuk nënkupton edhe kalimin e pronësisë, pa qenë më parë e regjistruar në ZVRPP. Sipas logjikës së pretendimit të subjektit mbi këtë rrethanë, bërija e banueshme e kësaj sipërfaqeje ndërtimore (*pas marrjes në dorëzim karabina*) detyrimisht u nënshtrohet në vijim inspektimeve dhe miratimeve të posaçme nga Bashkia (*leje e re ndërtimi*), për shkak se del nga kuadri i lejes së ndërtimit për shoqërinë ndërtuese. Për pasojë, në këtë linjë arsyetimi, subjekti rezultojnë që të ketë kryer punime ndërtimi pa një leje të posaçme, pra ndërtim të paligjshëm.

Në muajin shkurt 2004, sipërfaqja në fjalë nuk ishte ende e regjistruar në ZVRPP Durrës në emër të shoqërisë "(***)" sh.p.k. dhe në vijim, punimet në këtë apartament, deri në mbarimin e tij në muajin dhjetor 2004, janë realizuar në bazë të lejes së ndërtimit të dhënë nga Bashkia Durrës për të gjithë pallatin që po ndërtonte kjo shoqëri ndërtimi. Për pasojë, subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur asnjë mundësi të marrë apartamentin në dorëzim në gjendje karabina dhe, pas kësaj e më tej, të bëjë punime ndërtimi në vijim sipas ligjit.

Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit, se kontrata e sipërmarrjes nuk është respektuar pasi me anë të deklaratës noteriale me nr. (***) rep. nr. (***) kol., datë 11.08.2004, revokohet garazhi me vlerën 20.000 euro, dhe për rrjedhojë nuk ka kryer pagesë të kësaj të parë, trupi gjykues ka konstatuar se:

- *Në përmbajtje të deklaratës, palët janë shprehur vetëm se marrëdhënia e tyre do të vazhdonte për apartamentin 157 e jo për garazhin, por në përmbajtje të saj nuk deklarohet për kthimin e pagesës 20 mijë euro, e cila sipas kontratës së sipërmarrjes, në vitin 2004, ishte deklaruar e paguar para noteres, e cila konfirmoi se nuk ka asnjë lapsus edhe për sa i përkiste nenit 6.1 të kësaj kontrate.*

Gjithashtu, lidhur me deklaratat e noterit publik, subjekti i rivlerësimit u pyet në seancën dëgjimore nga ana e Komisionit, pasi nuk e gjente të mbështetur pretendimin e tij se deklarata e noterit publik², lëshuar 8 ditë më vonë pas asaj që i ishte nisur Komisionit³, të ketë mohuar këtë pagesë. Në këtë deklaratë, noterja publike është shprehur vetëm se: "Nuk mban mend nëse

²Shih deklaratën e noterit publik me iniciale A.Sh., lëshuar, sipas kërkesës së subjektit, datë 20.07.2018.

³Shih deklaratën e noterit publik me iniciale A.Sh., lëshuar sipas kërkesës së Komisionit, më datë 12.07.2018.

mes palëve të jetë lëshuar ndonjë mandat pagese për dorëzimin e kësaj shume dhe se kjo shumë të jetë likuiduar në zyrën e saj”.

Në çmuarje të fakteve dhe provave sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit, se nuk e ka kryer pagesën e kështit të parë prej 20.000 eurosh në prani të noterës, bie në kundërshtim me përmbajtjen në kontratën noteriale të nënshkruar prej tij, si dhe nuk shoqërohet me një akt shkresor të kohës me vlerë të njëjtë juridike që provon pavërtetësinë e deklaratimit të kësaj pagese, për rrjedhojë mbetet pretendim i pambështetur në prova.

Lidhur më deklarin e subjektit të rivlerësimit, se fillimisht për këtë pasuri ka kryer pagesë *cash* 2.000 euro parapagim (*deklaruar në vitet 2003 - 2004*), trupit gjykues nuk i rezulton: as në deklaratën e vitit 2003 dhe as në deklaratën e vitit 2004 që nga subjekti të jetë deklaruar ndonjë pagesë *cash* e shumës 2.000 euro te shoqëria “(***)” sh.p.k.

Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit nuk e shoqëron këtë deklarin me asnjë provë shkresore që vërteton pagesën ndaj një subjekti tregtar, faturë/mandat pagese në arkën e shoqërisë tregtare. Pretendimet e subjektit nuk mbështeten në asnjë dokument financiar, mandat arkëtimi/faturë apo transaksion me bankë, prej të cilave Komisioni nuk gjen asnjë përputhje: as sipas vlerës së situacioneve të punimeve të pretenduara në vlerën 3.000.000 lekë, sipas kontratës së shitblerjes, dhe as 2.400.000 lekë, sipas preventivit pas verifikimit.

Mbi pretendimin tjetër të subjektit, paraqitur pas kalimit të barrës së provës, se pagesat për këtë pasuri ishin kryer vetëm pasi vlera prej 40.000 eurosh kishte kaluar në llogarinë e shoqërisë “(***)” sh.p.k. në datën 28.07.2004 dhe se kjo shumë, për të rakorduar me marrjen në dorëzim të apartamentit karabina dhe për përfundimin e punimeve të mëtejshme *“i ishte kthyer nga shtetasi P. K.”*. Duke vijuar me deklarin se: *“Më pas, shumën 39.094 euro e ka depozituar cash më datë 29.07.2004 në ‘NBG Bank’ dhe deri në dhjetor të 2004-s realizohen punimet për përfundimin e apartamentit, sipas situacionit të punimeve, me vlerë 2.400.000 lekë, si dhe me deklarin që: “Vlera 5.400.000 lekë i është likuiduar shoqërisë ‘(***)’ sh.p.k. dhe nënkontraktorëve për përfundimin e punimeve sipas lëvizjeve bankare pranë ‘NBG Bank Albania”.*

Komisioni çmon se:

Subjekti i rivlerësimit këtë deklarin e paraqiti për herë të parë në parashtrimet pas kalimit të barrës së provës, i cili, në përmbajtje, bie në kundërshtim me faktet dhe provat e administruara nga Komisionit, pasi:

Në deklaratën e pasurisë së vitit 2004 nuk rezulton të jetë deklaruar si e ardhur kthimi i vlerës 39.094 euro, me burim nga shtetasi P. K. ose, anasjelltas, moskryerja e punimeve deri në shumën e kontraktuar në sipërmarrje duhej deklaruar si një detyrim/kredi e papërbushur nga subjekti i ndërtimit.

Subjekti i rivlerësimit nuk depozitoi asnjë dokument financiar, mandat arkëtimi apo transaksion me bankë, që të vërtetojë se këto fonde iu rikthyen. Gjithashtu, edhe në pasqyrat e llogarisë bankare të subjektit dhe të bashkëshortes së tij, nuk rezulton asnjë pagesë e kryer në favor të ndonjë subjekti ndërtimi, për këtë destinacion apo qëllim.

Mbi këtë pretendim të subjektit, trupi gjykues konstaton se një fakt i tillë nuk rezulton as në deklaratën noteriale të lëshuar nga shoqëria “(***)” sh.p.k., për mënyrën e likuidimit të pasurisë më datë 20.07.2018, që vetë subjekti i rivlerësimit depozitoi gjatë hetimit administrativ, në të cilën nuk rezulton të jetë deklaruar as kthim shume, as pagesa të pjesshme, me këtë destinacion, sipas lëvizjeve bankare të pretenduara nga subjekti. Ky pretendim nuk qëndron edhe për faktin se në këtë llogari bankare konstatohet se në fund të vitit 2004, shuma

e mbetur gjendje është 10.014 euro, shumë të cilën subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar si gjendje në deklaratën e pasurisë së vitit 2004.

Trupi gjykues çmon se shuma 39.064 euro, e depozituar *cash* në llogarinë personale të personit të lidhur në “NGB Bank”, më datë 29.07.2004, për të cilën subjekti i rivlerësimit deklaroi se iu kthye *cash* nga shtetasi P. K., një ditë pasi ia kishin transferuar (më datë 28.04.2004) në llogarinë bankare të shoqërisë tregtare “(***)” sh.p.k., në kushtet e paprovueshmërisë me dokument ligjor, passjell çmuarjen e saj si pasuri/likuiditet të padeklaruar, si dhe pa një burim të ligjshëm.

Në analizë të deklarimeve të dhëna për çmimin e blerjes së kësaj pasurie, trupi gjykues vlerëson se, në cilindo variant të analizohen deklaratimet e subjektit, ato nuk përputhen me faktet, pasi, gjatë hetimit administrativ, ai ka deklaruar se në dhjetor të vitit 2004 ka marrë në dorëzim apartamentin me sipërfaqe 157 m² në gjendje të përfunduar e, për rrjedhojë, në momentin e nënshkrimit të kontratës së shitblerjes çmimi i kontratës nuk reflekton çmimin e paguar realisht për atë pasuri tek pala shitëse.

Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se konkluzionet e mësipërme bazohen në dokumentacionin zyrtar, të formalizuar përpara noterit publik (*kontrata e porosisë dhe deklarata e noterit publik*), si dhe në transaksionet bankare, të cilat juridikisht kanë nivel provueshmërie deri në provën e kundërt. Duke qenë se për të kundërtën e konstatimeve nga Komisioni, subjekti ngriti vetëm pretendime të pambështetura në prova, si dhe duke qenë se nga këto pretendime rezultojnë rrethana të ndryshme dhe në kundërshtim me aktet noteriale të kohës që subjekti pranon se i ka nënshkruar vetë, trupi gjykues çmon se pretendime të tilla nuk janë bindëse, si dhe japin një paraqitje të pasaktë të çmimit të blerjes së kësaj pasurie.

II. Pasuria shtesë apartamenti, me sipërfaqe 30 m², rezultoi e fituar në bazë të kontratës nr. (*) , datë 24.04.2007,** kundrejt çmimit 1.400.000 lekë, për të cilën subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se *de facto* e kishte blerë që në momentin e blerjes së apartamentit 157 m², po me kredinë.

II.1 Faktet e konstatuara nga Komisioni, si dhe provat e administruara për vërtetimin e tyre gjatë hetimit administrativ

Me shkresat nr. (***) prot., datë 30.01.2018, dhe nr. (***) prot., datë 17.04.2018, prej Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës, në lidhje me këtë pasuri, provohet se kjo shtesë:

- është pjesë e apartamentit nr. (***) , në katin e (***)-të të ndërtimit (kati i (***)-të i banimit) me sip. 95 m², që në fund të muajit nëntor 2004, regjistruar në pronësi të P. K. më datë 15.05.2006;
- veçohet si pasuri nga apartamenti me sipërfaqe 95 m², me kërkesën e datës 07.02.2007, të shtetasit P. K., drejtuar ZVRPP-së Durrës;
- regjistrohet si pasuri më vete në pronësi të P. K. më datë 07.03.2007 (ZVRPP Durrës e pajis këtë shtetas me certifikatë pronësie më datë 20.03.2007);
- me kontratën e shitblerjes nr. (***) , datë 24.04.2007, ka kaluar në pronësi të subjektit *ipso jure*.

Lidhur me pagesat për pasurinë shtesë, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka paguar 6.000 (gjashtë mijë) euro në vitin 2005 dhe 5.000 (pesë mijë) euro në vitin 2006, total 11 mijë euro, ndërsa në vitin 2007 ka deklaruar se në total ka paguar 12.000 (dymbëdhjetë mijë) euro në këto

dy vite. **Por, pagesat sipas këtyre deklarimeve, Komisionit nuk i rezultuan të mbështetura nga ana e subjektit me një dokument pagese sipas ligjit.**

Gjatë hetimit administrativ, subjekti deklaroi se për blerjen e kësaj shtese apartamenti kishte paguar 4.000 euro dhe 8.000 euro, me burim: kredinë nga kontratat nr. (***) , datë 26.07.2004 (40.000 euro) dhe nr. (***) , datë 16.12.2004 (8.000 euro). ***Por, këto të ardhura, sipas deklaramit të tij në vitin 2004 dhe dokumentacionit të kontratave të kredisë, i kishte paguar ndaj subjektit tregtar “(***)” sh.p.k. për llogari të blerjes së apartamentit me sip.157 m², që ishte objekt i kontratës së sipërmarrjes në vitin 2004.***

Në analizim të deklarimeve dhe vlerësim të dokumentacionit ligjor/financiar, Komisionit i rezultoi se nuk vërtetohej asnjë nga pagesat e deklarimeve të tij në DVP-të e viteve 2005, 2006 për këtë pasuri, dhe as në DVP/2007, viti i lidhjes së kontratës së shitblerjes.

II.2 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

Subjekti i rivlerësimit, pasi u njoh me dosjen dhe me rezultatet e hetimit të Komisionit, në shpjegimet e tij, të paraqitura pas kalimit të barrës së provës, si dhe në seancën dëgjimore, ka parashtruar se:

“Mospërputhjet midis deklaramit të kësaj pasurie në deklaratat vjetore 2004, 2005, 2006, 2007 dhe deklaramit në deklaratën “Vetting” ka ardhur si pasojë e faktit që punimet janë kryer në vitin 2004, dokumentacioni ka vazhduar në 2005-ën deri në vitin 2007 (*sipërfaqja shtesë 30 m²*), ndërsa likuidimet janë mbyllur në vitet 2006 - 2007. Pasuria shtesë 30 m² ka kushtuar 1.400.000 lekë, që së bashku me apartamentin e banimit 157 m², si blerje totale nga shoqëria “(***)” sh.p.k. në vlerë financiare ka kushtuar 6.800.000 lekë. Në kontratën e shitblerjes së lidhur në vitin 2007, me çmim 1.400.000 lekë, është theksuar fakti që shuma është likuiduar një vit më parë, në 2006-ën. *Shuma⁴ e likuiduar është 8.000 euro nga shtesa e kredisë nr. (***) , datë 16.12.2004, shtesa e kredisë prej 8.000 eurosh e barabartë me vlerën 1.000.000 lekë, diferenca prej 400.000 lekësh.* Në raportimet për vitet 2005, 2006, 2007 kanë ndodhur përsëritje të shumave të investuara si pasojë e pamundësisë së likuidimit në kohë të shoqërisë ndërtuese dhe ky likuidim është bërë në momentin e aprovimit të kredisë. Kjo ka sjellë si pasojë raportime të të njëjtit investim në dy vite të ndryshme. Kërkohej mirëkuptim në këto gabime në raportim, por asnjëherë fshehje të qëllimshme”.

II.3 Arsyetimi ligjor në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

Mbi deklarimin e pagesave të kryera për këtë pasuri në deklaratën “Vetting”, deklarimeve të tij në deklaratat periodike të viteve 2005, 2006 dhe në deklaratën periodike të vitit 2007, me lidhjen e kontratës së shitblerjes, trupi gjykues, në analizë të pretendimeve të ngritura nga subjekti në parashtrësë, pas kalimit të barrës së provës, por edhe në seancën dëgjimore, vlerëson se:

Subjekti i rivlerësimit nuk solli asnjë provë që të vërtetojë të kundërtën e situatës së provuar gjatë hetimit administrativ. Për rrjedhojë, nuk u vërtetua asnjë nga pagesat e deklarimeve të tij në DVP-të e viteve 2005, 2006 për këtë pasuri, dhe as në DVP/2007, me lidhjen e kontratës së shitblerjes, për pasojë edhe në atë “Vetting”.

Pretendimi i subjektit, se shumat 4.000 euro dhe 8.000 euro kanë si burim kredinë nga kontratat nr. (***) , datë 26.07.2004 (40.000 euro) dhe nr. (***) , datë 16.12.2004 (8.000 euro), bie në

⁴ Citimi i subjektit në parashtrimet e tij.

kundërshtim me deklarin e tij në vitin 2004 dhe dokumentacionit të kontratave të kredisë, sipas të cilit, shumat e kredisë i kishte paguar ndaj subjektit tregtar “(***)” sh.p.k. për llogari të blerjes së apartamentit me sip. 157 m², që ishte objekt i kontratës së sipërmarrjes në qershor të vitit 2004.

Pretendimi i subjektit se, për këtë pasuri ka paguar 6.000 euro në vitin 2005 dhe 5.000 euro në vitin 2006 (në total 11.000 euro), si dhe deklarimi në deklaratën e pasurisë së vitit 2007 se, në total, ka paguar 12.000 euro në këto dy vite, jo vetëm që kanë përmbajtje deklarimesh kontradiktore mes tyre, por në analizë të tyre, Komisionit i rezulton se këto deklarime:

- *nuk përputhen me faktet dhe dokumentacionin ligjor e financiar të siguruar gjatë hetimit administrativ;*
- *nuk provojnë kryerje pagesash bazuar në një mjet pagese sipas dispozitave ligjore;*
- *nuk janë riprodhim i deklarimeve periodike (përkatësisht për vitet 2005 dhe 2006) dhe mungojnë tërësisht referencat sipas pretendimeve të subjektit në deklarin e tij të pasurisë të vitit 2007.*

Shpjegimi i subjektit se kemi të bëjmë me gabime në raportim për shumat e investuara për krijimin pasurisë me dy pjesë, nuk qëndron, për pasojë nuk janë bindëse për faktin se vetë subjekti pranon se mënyra e deklarin lidhet me ecurinë e dokumentacionit, çka do të thotë që deklarinet duhej të mbështeteshin në dokumentacionin që provon veprimet e ndërmarra nga ana e tij dhe nuk mund të konsiderohen si gabime në raportim. Ky deklarim i subjektit të rivlerësimit konfirmon faktin se ai nuk ka dorëzuar deklarime të sakta të pasurisë dhe në të njëjtën kohë, mospërputhjet mes pagesave reale dhe pagesave të kontratës së shitblerjes, me ato të deklaruara nëpër deklarinet vjetore periodike 2004, 2005, 2006, 2007, nuk janë rezultat i ndonjë gabimi në shkrim apo i moskuptimit të mënyrës së hartimit të tyre.

Gjithashtu, trupi gjykues arrin në vlerësimet e sipërcituara edhe për faktin se subjekti i rivlerësimit pretendon se sipërfaqja shtesë 30 m² u porositi *de facto* që në vitin 2004, version i ri ky, për të cilin subjekti nuk ka deklaruar në këtë mënyrë në deklaratën periodike, si dhe nuk ka dorëzuar asnjë provë që të vërtetojë faktet e pretenduara. Ndërkaq, nga përmbajtja dhe materialet shoqëruese të shkresave nr. (***) prot., datë 30.01.2018, dhe nr. (***) prot., datë 17.04.2018, të Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës (administruar si prova në dosje nga Komisioni), provohet se kjo shtesë e apartamentit është veçuar si pasuri nga apartamenti me sipërfaqe 95 m², me kërkesën e datës 07.02.2007 të shtetasit P. K. dhe me kontratën e shitblerjes nr. (***), datë 24.04.2007, e ka tjetërsuar duke e kaluar në pronësi të subjektit *de jure*.

Përfundimisht, në analizë të provave të administruara në lidhje me pasurinë apartament, me sipërfaqe 157 m², plus shtesë me sipërfaqe 30 m² (total 187m²) në qytetin e Durrësit, pallati “(*)”, trupit gjykues i rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka sjellë asnjë argument dhe asnjë provë që të hedhë poshtë apo të ndryshojë rezultatin e hetimit dhe konkluzionin e Komisionit në hetimin administrativ.**

III. Pasuria shtëpi banimi në Lagjen (*)**, Durrës, me sipërfaqe 85.4 m², kati i (***) , sh. (***) , ap. (***) , sipas kontratës së sipërmarrjes me shoqërinë “(***)” sh.p.k., me datën 27.10.2007, apartament i blerë në vlerën 93.940 euro.

Burimi: Me anë të kredisë, po pranë “NBG Bank” sh.a., me një vlerë prej 70.000 eurosh, sipas kontratës së kredisë me nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 29.01.2018; nga shitja e një pasurie, apartament banimi, sipas kontratës me nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 23.09.2005, pasuri e shitur në vlerën 2.000.000 lekë; dhe nga kursimet. Kjo pasuri nuk është regjistruar pranë ZVRPP-së Durrës nga ana e shoqërisë së ndërtimit dhe, për rrjedhojë, disponohet me anë të

kontratës së sipërmarrjes. Vlera: 93.940 euro. Pjesa takuese: 50 %, nën regjimin pasuror martesor.

III.1 Faktet e konstatuara nga Komisioni, si dhe provat e administruara për vërtetimin e tyre gjatë hetimit administrativ

Kjo pasuri rezultoi të jetë fituar me anë të kontratës së sipërmarrjes së datës 20.10.2007 me shoqërinë “(***)” sh.p.k., për të cilën personi i lidhur/bashkëshortja kishte rënë dakord për ndërtimin e një apartamenti me sipërfaqe 85.4 m², që po ndërtonte kjo shoqëri në truallin e familjes Ç., Lagjja (***), Durrës.

Në përmbajtje të kontratës rezultoi se çmimi i kontratës është përcaktuar për njësi 1.100 euro/m², me vlerë totale 93.940 euro, nga të cilat, në ditën e nënshkrimit të saj nga palët, deklarohet se janë parapaguar 23.940 euro, ndërsa pjesa tjetër, prej 70.000 eurosh, do të likuidohet nëpërmjet një kredie që do të merret nga “NBG Bank”, dega Durrës. Kjo bankë e ka miratuar kredinë e kërkuar. Por, në kontratën e kredisë nr. 313/39, datë 25.01.2008, deklarohet se kjo ka financuar kredimarrësit A. H. dhe Bujar Hoti me shumën 70.000 euro për blerjen e dy apartamenteve nga shoqëria “(***)” sh.p.k. Në këto kushte, Komisioni krijoi dyshime të arsyeshme mbi vërtetësinë e transaksionit dhe burimin e ligjshëm të financimit, bazuar në faktin e nënshkrimit nga personi i lidhur të dy kontratave me të njëjtën shoqëri tregtare: njëren për ndërtimin e një apartamenti (*depozituar në ILDKPKI*) dhe tjetrën për ndërtimin e dy apartamenteve (*dorëzuar në bankë për të përfituar kredi*), si dhe mbi deklarimin për pagesën e çmimit.

Në vijim të dyshimeve, Komisioni hetoi mbi zhvillimin e të gjitha çështjeve me natyrë ligjore dhe ekonomike që lidheshin me godinën e ndërtuar nga shoqëria “(***)” sh.p.k. (*në të cilën identifikohen dy apartamentet e porositura*).

Për apartamentet në fjalë, nga hetimi administrativ rezultoi se janë:

- Pjesë e pallatit të ndërtuar nga shoqëria “(***)” sh.p.k., me investimin e shoqërisë “(***)” sh.p.k., në bazë të lejes së sheshit dhe të ndërtimit të lëshuar nga Bashkia Durrës në truallin pronë e familjes Ç.;
- Pjesë e vlerës së situacioneve që shoqëria “(***)” sh.p.k. ka shitur te shoqëria “(***)” sh.p.k., në bazë të një akt marrëveshjeje mes këtyre dy subjekteve (kostoja e ndërtimit të secilit prej këtyre dy apartamenteve llogaritet të jetë 2.260.790,78 lekë - sipas raportit të kontrollit tatimor që përcakton kostot e ndërtimit të pallatit)⁵;
- Objekt i njëres marrëveshjeje mes shoqërisë “(***)” sh.p.k. dhe porositëses A. H., e cila e likuidon atë brenda vitit 2007 në shumën totale prej 2.932.650 lekësh, pasqyruar në dy mandate arkëtimi për shumat 2.000.000 lekë (nr. (***), datë 20.10.2007) dhe 932.650 lekë (nr. (***), datë 20.12.2007) të lëshuara nga “(***)” sh.p.k.;
- Objekt i kontratës së sipërmarrjes, datë 20.10.2007, mes porositëses A. H. dhe shoqërisë “(***)” sh.p.k., për çmim njësi 1.100 euro/m², me vlerë totale 93.940 euro, nga të cilat deklarohet janë likuiduar 23.940 euro në momentin e nënshkrimit (*kjo kontratë deklarohet në ILDKPKI*);
- Objekt i kontratës së sipërmarrjes datë 20.10.2007 mes porositëses A. H. dhe shoqërisë “(***)” sh.p.k., për ndërtimin e dy apartamenteve (nr. (***) dhe nr. (***)) në të njëjtin pallat me çmim njësi 550 euro/m², me vlerë totale 93.940 euro, nga të cilat, deklaruar se janë likuiduar 23.940 euro në momentin e nënshkrimit (*kjo kontratë deklarohet në “NBG Bank”, e cila miraton një kredi prej 70.000 eurosh, disburson shumën 68.578*

⁵Shih shkresën nr. (***) prot., datë 24.07.2018, dhe materialet shkresore bashkëlidhur të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Durrës.

euro, pasi i ka mbajtur kostot e kredisë, shumë që transferohet pa përshkrim qëllimi në llogarinë bankare të shtetasit S. H. - administrator i shoqërisë “(***)” sh.p.k.)⁶;

- Regjistruar në pronësi të shoqërisë “(***)” sh.p.k., së bashku me të gjitha ambientet e tjera të pallatit ku ndodhet ky apartament, në ZVRPP Durrës⁷;
- Objekt i kontratës së shitblerjes nr. (***) , datë 23.07.2018 (kalimi *de jure* i pronësisë) mes palës shitëse shoqëria “(***)” sh.p.k. dhe palës blerëse A. H., për çmimin 93.940 euro, të likuiduar sipas mënyrës së deklaruar nga subjekti i rivlerësimit (pa marrë parasysh detajet që lidhen me shumat reale dhe efektive të paguara dhe as subjektin që i ka përfutur realisht dhe efektivisht këto shuma - përfaqësuesja me autorizim e shoqërisë “R.” sh.p.k. deklaroi se në këto pika kontrata ka gabime)⁸.

Lidhur me konstatimet e sipërcituara, Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit të japë shpjegime, ku ai deklaroi se:

- *Më datë 20.10.2007 ka nënshkruar me shoqërinë “(***)” sh.p.k. kontratë sipërmarrjeje vetëm për një apartament, për çmim njësi 1.100 euro/m², me vlerë totale 93.940 euro.*
- *Kontratën tjetër, të datës 20.10.2007, po me shoqërinë “(***)” sh.p.k., për dy apartamente, me çmim njësi 550 euro/m² dhe vlerë totale po 93.940 euro, e ka çmuar “lapsus” të firmës së ndërtimit.*
- *Apartamentin e ka marrë në dorëzim në fund të vitit 2008, të përfunduar, me çelësa në dorë.*
- *Për mobilimin e banesës në Durrës, ka paguar shumën 200.000 lekë të rinj, sipas faturës 91.31 të datës 19.01.2008 nga mobiliери “A. P.” dhe pjesa tjetër e mobilieve janë ato të apartamentit me sipërfaqe 157 m².*
- *Likuidimin e apartamentit (në variantin final të përgjigjeve tij) e ka bërë përmes:*
 - *mandatarkëtimit (“(***)” sh.p.k.) nr. (***) , datë 20.10.2007, paguar shuma 2.000.000 lekë;*
 - *mandatarkëtimit (“(***)” sh.p.k.) nr. (***) , datë 20.12.2007, paguar shuma 932.650 lekë;*
 - *transfertës bankare të shumës 70.000 euro, datë 28.01.2008, nga llogaria bankare me nr. (***) , sipas kontratës së kredisë me nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 25.01.2008;*
 - *mes shoqërisë “(***)” sh.p.k. dhe shoqërisë “(***)” sh.p.k. ka një marrëveshje për bashkëpunim në fushën e ndërtimit, në lidhje me godinën në pronën e familjes Ç., ku shoqëria “(***)” sh.p.k. është investitore dhe shoqëria “(***)” sh.p.k. është sipërmarrëse në zbatimin e punimeve të ndërtimit;*
 - *burimi i të ardhurave për krijimin e kësaj pasurie ka qenë 2.000.000 lekë nga kontrata e shitblerjes nr. (***) , datë 23.09.2005 (me blerësin H. S.), si dhe 600.000 lekë kursime të vitit 2005.*

Subjekti i rivlerësimit, gjatë hetimit administrativ, depoziton pranë Komisionit kontratën e shitblerjes nr. (*) , datë 23.07.2018, të nënshkruar nga pala shitëse, shoqëria “(***)” sh.p.k. dhe pala blerëse, znj. A. H., me objekt kalimin e pronësisë së apartamentit me sipërfaqe totale 82.5 m², kundrejt çmimit 93.940 euro. Bashkëlidhur kontratës depozitohen: kontrata e sipërmarrjes datë 20.10.2007 (me një apartament); dokumentacioni i pronësisë së shoqërisë “(***)” sh.p.k.; dy mandate arkëtimi për shumat 2.000.000 lekë (nr. (***) , datë 20.10.2007) dhe 932.650 lekë (nr. (***) , datë 20.12.2007), të lëshuara nga “(***)” sh.p.k., si dhe pasqyra e llogarisë bankare “NBG Bank” për transferimin e shumës 68.578 euro nga llogaria e kredisë së A. H. dhe Bujar Hotit në llogarinë rrjedhëse të shtetasit S. H.**

⁶Shih shkresat nr. (***) , datë 31.01.2018, dhe nr. (***) , datë 13.07.2018 dhe materialet shkresore bashkëlidhur të “NBG Bank”.

⁷Shih shkresën nr. (***) prot., datë 20.07.2018, dhe materialet shkresore bashkëlidhur të ZVRPP-së Durrës.

⁸Shih procesverbalin e datës 31.07.2018 “Për marrjen e deklarimeve të shtetas B. B., përfaqësuese e shoqërisë “(***)” sh.p.k..

Komisioni konstatoi mospërputhje⁹ në analizën e deklarimeve të subjektit, të deklarimeve të bëra në kontratën e shitblerjes nga personi i lidhur dhe nga shoqëria “(***)” sh.p.k., për mënyrën e likuidimit dhe transaksionet e kryera afro 10 vite më parë me një tjetër subjekt tregtar (“(***)” sh.p.k.), në raport me dokumentacionin bankar të cituar më sipër (të bankës “NBG”), si dhe me materialet shkresore bashkëlidhur shkresës nr. (***) prot., datë 24.07.2018, të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Durrës. Kjo e fundit ka përcjellë pranë Komisionit të gjithë dokumentacionin që lidhet me kontrollin tatimor të ushtruar ndaj shoqërive “(***)” sh.p.k. dhe “(***)” sh.p.k., për aktivitetin financiar të kryer në lidhje me ndërtimin e pallatit në pronën e familjes Ç., në zonën e Durrës, në vitet ushtrimore 2007, 2008 e në vijim.

Ky institucion ka kryer disa akte konstatimi dhe ka nxjerrë edhe raporte kontrolli. Nga këto materiale (kryesisht nga raporti përfundimtar i kontrollit, datë 15.08.2011, fq. 6) rezulton se: shoqëria “(***)” sh.p.k. ka qenë në rolin e subjektit sipërmarrës, që kishte si detyrë të realizonte vetëm punimet e ndërtimit, të cilat, më pas, në formën e situacioneve ia shiste shoqërisë investitore “(***)” sh.p.k. Kjo e dyta (“(***)” sh.p.k.) rezulton që të jetë shoqëria që mund të kryente transaksionet, pra të lidhte kontrata për sipërmarrjen, porositjen apo shitblerjen e sipërfaqeve ndërtimore që merrte në dorëzim si investim nga zbatuesi i punimeve (“(***)” sh.p.k.). Gjithashtu, rezulton që, nga kontrolli tatimor i ushtruar në këto dy subjekte, është përcaktuar edhe kostoja për metër katror për ndërtimin e realizuar në vitin 2008, në shumën 26.472,96 lekë/m² me TVSH.

Nga praktika e DRT-së Durrës, në librin e arkës dhe në librin e bankës së shoqërisë “(***)” sh.p.k., për vitin 2007 dhe 2008, nuk rezulton asnjë arkëtim i shumave 23.940 euro dhe as i shumës 70.000 euro nga subjekti i rivlerësimit dhe as nga personi i lidhur/bashkëshortja. Sikurse evidentohet në raportet e kontrollit, shoqëria “(***)” sh.p.k. kishte vetëm një klient: Shoqërinë “(***)” sh.p.k. Po kështu, edhe nga shoqëria “(***)” sh.p.k. nuk rezulton asnjë arkëtim i këtyre shumave në vitin 2008 (shumat e deklaruara në kontratën e shitblerjes së apartamentit).

Për sa më sipër, Komisioni kërkoi dhe mori deklarime nga përfaqësuesja me autorizim e shoqërisë “(***)” sh.p.k., sipas së cilës, shoqëria “(***)” sh.p.k. ka pasur aktivitet vetëm shitjen e situacioneve të “(***)” sh.p.k. dhe porositja e apartamenteve mund të bëhej vetëm të “(***)”, pasi ky subjekt ishte investitori. Sa i takonte kontratës së shitblerjes nr. (***), datë 23.07.2018, të apartamentit në fjalë, deklarohet se përshkrimi i vlerave të pagesës së çmimit dhe mënyra e likuidimit të tyre është bërë në mënyrë të gabuar.

Në analizim të kontratës së sipërmarrjes së datës 20.10.2007, që subjekti bashkëlidh me kontratën e shitblerjes nr. (***), datë 23.07.2018, konstatohet se: në kontratën e sipërmarrjes porositet një apartament me sipërfaqe 85.4 m², kundrejt çmimit 1.100 euro/m², me vlerë totale 93.940 euro; ndërsa në kontratën përfundimtare është shitur një sipërfaqe totale prej 82.5 m², pra rezultojnë që të jenë zbritur 3 m², me vlerë totale 3.300 euro, të cilat nuk rezultojnë që të kthehen te pala blerëse. Gjithashtu, subjekti deklaroi se ka paguar më datë 20.10.2007 shumën 2.000.000 lekë të shoqëria investitore “(***)” sh.p.k., por kjo shumë nuk është e barabartë me shumën 23.940 euro (është më e vogël). Subjekti deklaroi se i ka paguar kësaj shoqërie tregtare edhe 932.650 lekë më datë 20.12.2007, por edhe me këtë shumë të dytë, përsëri nuk plotësohet vlera e 23.940 euro, duke e bërë të pamundur deklarinë në kontratën e sipërmarrjes se deri më datë 20.10.2007 janë parapaguar 23.940 euro.

⁹ Refero faqen 16.

Nga analizimi i fakteve dhe rrethanave të mësipërme, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit lidhur me:

a) mospërputhjet midis deklarimit të kësaj pasurie në deklaratat vjetore 2007, 2008 dhe deklarimit në deklaratën “Vetting”, pasi:

- Rezultoi se në deklaratën e pasurisë 2008 deklarohet blerja e pasurisë apartament me sipërfaqe 85.4m².
- e vlerë totale 93.940 euro, për të cilin është paguar 23.940 euro në vitin 2008 te shoqëria e ndërtimit “(***)” sh.p.k., ndërsa në deklaratën “Vetting” ka deklaruar se këtë apartament banimi me sipërfaqe 85.4 m² e ka likuiduar me shumat: 70.000 euro kredi dhe 2.000.000 lekë nga shitja e një apartamenti në vitin 2005 dhe kursime.
- Por, nuk rezultoi të ishin deklaruar pagesat që lidhen me këtë apartament në deklarimin vjetor të pasurive të vitit 2007 (viti i nënshkrimit të kontratës dhe i deklarimit të likuidimit paradhënie të shumës 23.940 euro) dhe as në deklarimin vjetor të pasurisë së vitit 2008 (likuidimin total të shumës 93.940 euro pas deklarimit të pagesës së shumës 70.000 euro të kredisë nga “NBG Bank”).

b) mospërputhjet midis deklarimeve vjetore të pasurive dhe deklarimit në deklaratën “Vetting” për këtë pasuri, në raport me dokumentacionin ligjor e financiar që vërteton transaksionet e kryera për krijimin e kësaj pasurie, pasi:

- Nuk rezultoi të ishin paguar 23.940 euro cash te shoqëria “(***)” sh.p.k., në momentin e nënshkrimit të kontratës, më 20 tetor 2007, pasi nga kontrolli i ushtruar pranë saj nga organet tatimore nuk rezulton që të ketë realizuar asnjë transaksion tjetër, përveçse ato me shoqërinë “(***)” sh.p.k.
- Por, nga ana tjetër, rezultoi se pagesat e kryera ndaj shoqërisë “(***)” sh.p.k., në shumën totale 2.932.650 lekë (sipas mandatarkëtimit nr. (***), datë 20.10.2007, në shumën 2.000.000 lekë, me përshkrimin: “Likuidim pjesor i apartamentit” në fjalë dhe mandatarkëtimit nr. (***), datë 20.12.2007, në shumën 932.650 lekë, me përshkrimin “Likuidim total” për blerjen e apartamentit) nuk rezultojnë të deklaruara në deklaratën vjetore të pasurisë së vitit 2007 dhe as në deklaratën “Vetting” të 2017-ës.

c) mospërputhjet midis deklarimeve të subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ në raport me dokumentacionin për transaksionet e kryera për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 85.4 m², pasi:

- Shuma 23.940 euro e deklaruar si e parapaguar te shoqëria “(***)” sh.p.k. deri më datë 20.10.2007 nuk provohet me asnjë mjet pagese të njohur nga legjislacioni. Përveç këtij fakti, shoqëria “(***)” sh.p.k. nuk ka realizuar asnjë shitje dhe asnjë transaksion me asnjë subjekt tjetër, civil ose tregtar, përveçse me shoqërinë “(***)” sh.p.k. Mandat arkëtimi nr. (***), datë 20.10.2007, në shumën 2.000.000 lekë, lëshuar nga shoqëria “(***)” sh.p.k. nuk përmban 23.940 euro dhe as kundërvlerën e këtyre.
- Shuma 70.000 euro, që deklarohet e paguar ndaj shoqërisë “(***)” sh.p.k. me transfertën bankare të datës 28.01.2008, nga llogaria e kredisë në “NBG Bank”, sipas kontratës së kredisë, nuk rezultoi e kryer sipas deklarimit. Pas zbritjeve që banka ka bërë për shpenzimet e kontratës së kredisë, rezulton se është transferuar shuma e mbetur prej 68.578 eurosh (pra jo 70.000 euro) në llogarinë rrjedhëse personale të shtetasit S. H., që në atë moment ka qenë administrator i shoqërisë “(***)” sh.p.k., por që ky pozicion nuk e identifikon atë si individ me personin juridik shoqëri tregtare.

Në përfundim të hetimit dhe analizimit të provave, Komisionit i rezultoi se shpenzimet e deklaruar: 93.940 euro për blerjen e këtij apartamenti, sikurse janë të renditura në kontratën e shitblerjes nr(***), datë 23.07.2018, si dhe mënyra e pagimit të tyre, nuk pasqyrojnë vlerën reale të paguar për krijimin e pasurisë apartament banimi, duke mos deklaruar destinacionin apo qëllimin e përdorimit të shumës 68.578 euro ndaj shtetasit S. H., pasi:

- ✓ **Përbënte fiktivitet çmimi dhe mënyra e pagesës në kontratën e shitblerjes;**
- ✓ **Përbënin fiktivitet dy kontratat e sipërmarrjes për një dhe për dy apartamente në pallatin që po ndërtonte shoqëria “(***)” sh.p.k. me investimin e shoqërisë “(***)” sh.p.k.**
- ✓ **Ishin kryer veprime fiktive me qëllim përfitimin e kredive bankare;**
- ✓ **Nuk rezultoi i deklaruar destinacioni i vërtetë i shumës 68.578 euro, që mbeti nga zbritja e kostove bankare të kredisë, pas disbursimit në llogarinë e personit të lidhur, të shumës 70 mijë euro, minus kosto kredie.**

III.2 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

Mbi konstatimet e Komisionit, në shpjegimet e tij, të paraqitura pas kalimit të barrës së provës, por edhe në seancën dëgjimore, ndër të tjera¹⁰, subjekti ka parashtruar se:

- Më datë 20.10.2007 ka nënshkruar me shoqërinë sipërmarrëse “(***)” sh.p.k. dhe me investitor “(***)” sh.p.k. një kontratë sipërmarrjeje vetëm për një apartament, për çmim njësi 1.100 euro/ m², me vlerë totale 93.940 euro.
- Këto shoqëri kanë një marrëveshje mes tyre më datë 12.05.2005 për bashkëpunim në fushën e ndërtimit, në lidhje me godinën në pronën e familjes Ç., ku shoqëria “(***)” sh.p.k. është investitore dhe shoqëria “(***)” sh.p.k. është sipërmarrëse në zbatimin e punimeve të ndërtimit
- Likuidimin e apartamentit e ka bërë në marrëveshje me të dyja shoqëritë, duke i parapaguar shoqërisë “(***)” sh.p.k. shumën 23.940 euro dhe shoqërisë “(***)” sh.p.k. shumën 70.000 euro, të provuara me anë të:
 - *Mandat arkëtimit (“(***)” sh.p.k.) nr. (***), datë 20.10.2007, paguar shuma 2.000.000 lekë;*
 - *Mandat arkëtimit (“(***)” sh.p.k.) nr. (***), datë 20.12.2007, paguar shuma 932.650 lekë;*
 - *transferts bankare të shumës 70.000 euro, datë 28.01.2008, nga llogaria bankare me nr. (***), sipas kontratës së kredisë me nr. (***) rep., nr. (***)kol., datë 25.01.2008 (banka mbajti komisionin dhe shpenzimet e kontratës dhe tarrsferoi sipas destinacionit të kredisë së dhënë shumën 68.758 euro te shoqëria “(***)” sh.p.k.);- për mënyrën e pagesave të mësipërme nuk ka asnjë ankesë nga asnjë palë.*

III.3 Arsyetimi ligjor në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

Trupi gjykues, në analizë të pretendimeve të ngritura në parashtrësë, pas kalimit të barrës së provës, por edhe në seancën dëgjimore vlerëson se:

- Lidhur me pretendimin se likuidimi i shumave të apartamentit ishte kryer te shoqëria “(***)”, fillimisht paguar një shumë paraprake (e pjeshme) prej 23.940 eurosh, e cila gjente pasqyrim përveçse në kontratën e porosisë, edhe në mandatpagesat e lëshuara nga shoqëria investitore “(***)” sh.p.k., nuk përputhen me faktet e konstatuara mbi pagesat në rend kronologjik, pasi rezultoi se më datë 20.10.2007 ishin paguar *cash* 2.000.000 lekë, që

¹⁰ Shih parashtrimet e subjektit në dosje.

nuk identifikojnë e as barazohen me shumën 23.094 euro. Subjekti i rivlerësimit nuk e shoqëroi deklarin me asnjë mjet pagese të kësaj shume në euro. Gjithashtu, në kontratën e datës 20.10.2007 deklarohet se shuma 23.940 euro i është paguar shoqërisë “(***)” sh.p.k. (që, ndër të tjera, s’kishte të drejtë që të lidhte kontrata për apartamentet me individë, pasi këtë mund ta bënte vetëm investitori “(***)” sh.p.k.), ndërsa 2.000.000 lekë i paguhen shoqërisë “(***)” sh.p.k., që ka shënuar edhe shkaku e pagesës në mandatin nr. (***), datë 20.10.2007, “Likuidim pjesor i apartamentit”).

Në vijim, në dhjetor të vitit 2007, shoqërisë “(***)” sh.p.k., dhe jo shoqërisë “(***)” sh.p.k., i janë paguar edhe 932.650 lekë të tjerë dhe, për këtë, investitori i pallatit “(***)” sh.p.k.) bën shënimin në mandatin e pagesës nr. (***), datë 20.12.2007, “Likuidim total i apartamentit”.

- Lidhur me pretendimin për pagesën e shumës 70.000 euro, si diferencë e çmimit të kontratës, me burim kontratën e kredisë më datë 25.01.2008, se kjo shumë i ishte disbursuar subjektit që mori lejen e ndërtimit, pra shoqërisë “(***)” sh.p.k., e cila përfaqësohej nga administratori S. H., - trupi gjykues çmon se ky deklarin nuk qëndron, sepse nuk rezultoi asnjë pagesë bankare nga subjekti dhe bashkëshortja për efekt të kontratës së sipërmarrjes me “(***)” sh.p.k. dhe për apartamentin në fjalë që, sikurse provohet me dy mandate pagesash, ishte likuiduar tërësisht ndaj shoqërisë “(***)” sh.p.k. më datë 20.12.2007.

Në shpjegimet parashtruara, konstatohet se subjekti i rivlerësimit nuk ka mbajtur në vëmendje detajin e shumës së kredisë së disbursuar, e cila nuk është 70.000 euro, por 68.578 euro dhe, sikurse rezultoi, kjo shumë i ka kaluar shtetasit S. H., por jo për efekt të ndonjë kontrate sipërmarrjeje¹¹, edhe pse ky ishte administrator i kësaj shoqërie.

- Lidhur me pretendimin e subjektit se kredia rezultoi të jetë miratuar në vlerën 70.000 euro, pasi janë bërë zbritjet e komisioneve në shumën 1.422 euro, shoqërisë i është bërë transaksioni në vlerën 68.578 euro në emër të administratorit S. H., me qëllim likuidimin e diferencës së mbetur nga kontrata e sipërmarrjes, - trupi gjykues konstaton se për herë të parë subjekti pranon se nuk ka transferuar 70.000 euro, por 68.578 euro (*pra shumë që ndryshon nga ajo e deklaruar të gjitha shpjegimet e tij, si dhe në kontratën përfundimtare të shitblerjes nr. (***), datë 23.07.2018*). Ndërkaq, vlerëson se kalimi i pagesës së çmimit në llogarinë rrjedhëse personale të administratorit nuk mund të konsiderohet i saktë nga ana e subjektit të rivlerësimit, pasi ato duhej të ishin kryer në emër të një shoqërie tregtare, e cila ka një mënyrë specifike të pasqyrit të të ardhurave dhe pagesave në llogaritë e saj dhe, po kështu, të kontrollit nga organet tatimore. Përveç sa më sipër, subjekti nuk e shoqëron me asnjë provë motivin e transferimit të shumës 68.578 euro te shtetasi S. H. dhe, nga ana tjetër, pa një shkak të caktuar nuk prezumon se pagesa është kryer për motivin e pretenduar nga subjekti.
- Lidhur me pretendimin e subjektit se pagesat provoheshin edhe me nënshkrimin e kontratës së shitblerjes nr. (***), datë 23.07.2018, ku është pranuar nga shoqëria “(***)” sh.p.k. se pagesat janë shlyer dhe blerësja A. H. nuk ka asnjë detyrim ndaj të dyja shoqërive, trupi gjykues vlerëson se ky deklarin bie në kundërshtim me faktet e konstatuara, por edhe me deklarin¹² e përfaqësueses së shoqërisë “(***)” sh.p.k., e cila deklaroi se kontratën e kishte nënshkruar në kushte specifike (*deklaron se ishte e sëmure dhe nënshkroi pa vëmendje*) dhe mënyra e pagesës së çmimit është e gabuar.

¹¹ Transferata bankare e datës 28.01.2004.

¹² Shih deklarin e përfaqësueses së shoqërisë “(***)” sh.p.k., datë 31.07.2018.

Trupi gjykues çmon se faktet e konstatuara janë të një niveli provueshmërie, si dhe nuk u kundërshtuan me asnjë provë nga subjekti i rivlerësimit.

Duke marrë në konsideratë faktet dhe provat se:

- bashkëshortja e subjektit ka nënshkruar dy kontrata të ndryshme me të njëjtin sipërmarrës, ku ndryshimi në secilën kontratë konsiston në sipërfaqen totale ndërtimore (85.4 m² dhe 170.8 m²) dhe çmimin njësi për metër katror (1.100 euro/m² dhe 550 euro/m²), por ka të njëjtë shumën e parapaguar deri në ditën e nënshkrimit të kontratës (23.940 euro) dhe vlerën përfundimtare totale të saj (93.940 euro);

- kontratën për ndërtimin e apartamentit me çmim 1.100 euro/m² e dorëzon në ILDKPKI dhe në Komision, si dokument për të justifikuar pagesën e shumës 93.940 euro për apartamentin në Durrës;

- kontratën për ndërtimin e dy apartamenteve me çmim 550 euro/m² e dorëzon në “NBG Bank”, për të justifikuar përfitimin e një kredie në shumën 70.000 euro, përmbajtjen e së cilës e mohon përpara Komisionit, duke e cilësuar si “lapsus” të firmës së ndërtimit (*duke injoruar në këtë mënyrë faktin se e kanë nënshkruar edhe ata këtë kontratë sipërmarrjeje si dhe, gjithashtu, kanë nënshkruar edhe kontratën e kredisë për dy apartamente*);

- sipas dokumentacionit të sjellë nga Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës, shoqëria “(***)” sh.p.k. (sot “(***)” sh.p.k.) nuk ka asnjë shitje të deklaruar ndaj klientëve të pallatit, pasi situacionet e saj ia shiste vetëm investitorit “(***)” sh.p.k.;

- nuk rezulton asnjë pagesë e shumës 70.000 euro për blerjen e apartamentit në, Durrës, në godinën e ndërtuar nga “(***)” sh.p.k. me investim të “(***)” sh.p.k.;

- nuk ka asnjë provë që pagesa e shumës prej 68.578 eurosh, e transferuar nga llogaria e kredisë së A. dhe Bujar Hotit në llogarinë e shtetasit S. H., të jetë dorëzuar në arkën apo në llogarinë e shoqërisë “(***)” sh.p.k., apo në arkën apo llogarinë e shoqërisë “(***)” sh.p.k.;

- nuk rezulton asnjë kthim i shumave të pretenduara si të parapaguara për 3 m² të papërfshira në sipërfaqen e blerë përfundimisht, me vlerë 3.300 euro, nga shoqëria “(***)” sh.p.k. te blerësja A. H.

Trupi gjykues arrin në përfundimin se ekzistojnë prova të plota që dëshmojnë se:

- **Kontrata e sipërmarrjes mes porositëses A. H. dhe sipërmarrësit “(***)” sh.p.k., datë 20.10.2007**, depozituar në ILDKPKI dhe në Komision, për një apartament në Durrës, me sipërfaqe 85.4m², për 1.100 euro/m², me vlerë totale 93.940 euro, përbën një akt fiktiv sa i takon: sipërfaqes së rënë dakord, çmimit për njësi metër katror dhe, për rrjedhojë, çmimit total të apartamentit.

- Në të njëjtën mënyrë, kontrata e sipërmarrjes mes porositëses A. H. dhe sipërmarrësit “(***)” sh.p.k., datë 20.10.2007, për dy apartamente në Durrës, e depozituar në “NBG Bank”, dega Durrës, me sipërfaqe 85.4m² secila (total 170.8m²), për 550 euro/m², me vlerë totale 93.940 euro, përbën një akt fiktiv sa i takon sipërfaqes së rënë dakord, çmimit për njësi metër katror dhe, për rrjedhojë, çmimit total të apartamentit.

- Për pasojë, kontrata e shitblerjes nr. (***), datë 23.07.2018, mes palës shitëse shoqëria “(***)” sh.p.k. dhe palës blerëse, znj. A. H., përmban edhe kjo fiktivitet sa i përket çmimit total të kontratës dhe mënyrës së likuidimit të pagesës nga pala blerëse.

Në konkluzion, për këtë pasuri trupi gjykues çmon se:

Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë në deklaratën e pasurisë së vitit 2008, në deklaratën “Vetting” të 2017-ës, si dhe nuk ka deklaruar saktë gjendjen e pasurisë në vitin 2007 sa u takon likuiditeteve dhe detyrimeve.

Subjekti ka kryer veprime fiktive sa i takon çmimit e mënyrave të pagesës në kontratën e shitblerjes për këtë pasuri, si dhe me qëllim përfitimin e kredive bankare në mënyrë të padrejtë, veprime që cenojnë rëndë figurën e tij si magjistrat.

Për sa më sipër, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit nuk ka respektuar nenin D të Aneksit të Kushtetutës, pika 1, i cili parashikon se: *“Subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen deklaramit dhe kontrollit të pasurive të tyre me qëllim që të identifikohen ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht, ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur”*, si dhe nenin 30 të ligjit nr. 84/2016 dhe shtojcën nr. 2 “Formulari i deklaramit të pasurisë”, të cilët parashikojnë se: *“Objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarami dhe kontrolli i pasurive të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij.*

IV. Pasuria njësi (zyrë noteriale), me nr. pasurie (***), zona kadastrale (***), me sipërfaqe 41.3 m², blerë në bazë të kontratës së shitblerjes me nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 11.08.2007.

Burimi: Pasuri e blerë nga të ardhurat e ushtrimit të aktivitetit (noteri).

Vlera e kontratës: 2.000.000 lekë.

Origjina: Apartament banimi, me leje ndërtimi nr. (***), datë 26.12.2007, për ndryshimin e destinacionit njësi dhe është bërë shtesë, po këtë vit, me një dhomë dhe një banjë (*sot në proces legalizimi sipas shkresës së ALUIZNI-t Durrës, nr. (***), datë 17.01.2017*), sipas preventivit të punimeve.

Vlera e punimeve për ndryshim destinacioni: 775.355 lekë.

Pjesa takuese: 100 %.

IV.1 Faktet e konstatuara nga Komisioni, si dhe provat e administruara për vërtetimin e tyre gjatë hetimit administrativ

Nga hetimi administrativ, bazuar në dokumentacionin zyrtar të institucioneve shtetërore dhe subjekteve të tjera të së drejtës publike, në dokumentacionin e dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit pranë ILDKPKI-së, në deklaramet periodike, në deklaramet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, si dhe deklaramet e marra nga dëshmitarët, për këtë pasuri konstatohet se:

Me kontratën e shitblerjes nr. (*)**, datë **11.08.2007**, konfirmohet se personi i lidhur/bashkëshortja ka blerë një apartament, për të cilin deklarohej se janë parapaguar 2.000.000 lekë si çmim i kësaj kontrate për kalimin e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme apartament banimi, me sipërfaqe 41.3 m², jashtë zyrës noteriale, shtetasve Xh. K., Sh. K., A.(A.) K. dhe M. K. (*përfaqësuar me prokurë nga Sh. K.*).

Lidhur me këtë pagesë, Komisioni konstatoi se çmimi i blerjes nuk rezultoi i paguar te pala shitëse (*anëtarët e familjes K.*).

Lidhur me këtë konstatim, për pagesën e çmimit të blerjes, Komisioni i kërkoi deklaramet subjektit të rivlerësimit, i cili shpjegoi se:

*“Shumën 2.000.000 lekë, që i përket çmimit për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 41.3 m², nuk ua kishte paguar drejtpërdrejt anëtarëve të familjes K., por me mirëkuptimin dhe miratimin e Sh. K., si dhe në marrëdhënie me shoqërinë “(***)” sh.p.k., bashkëshortja ka*

porositur te kjo e dyta një apartament 119 m², që t'ia kalojë në pronësi Sh. K., në ndërtesën që po ndërtonte kjo shoqëri ndërtimi, duke i likuiduar cash shumën 2.000.000 lekë.

Këtë deklarin subjekti i rivlerësimit e shoqëroi me: Kontratë sipërmarrjeje, datë 11.08.2007 midis palës porositëse A. H. dhe palës sipërmarrëse, shoqërisë “(***)” sh.p.k., si dhe fotokopje të mandatarëkëtimit datë 11.08.2007, pa numër, lëshuar nga shoqëria “(***)” sh.p.k., në shumën 2.000.000 lekë, paguar nga personi i lidhur, A. H., me përshkrimin “*Pagesë diference për blerjen e apartamentit, objekti ish-M.*”. Në **përmbajtje të kontratës konstatohet:** porositësja/bashkëshortja e subjektit kishte rënë dakord të blinte një apartament me sipërfaqe 119 m² dhe të paguajë për këtë shumën 2.000.000 lekë, ndërsa sipërmarrësi/shoqëria “(***)” sh.p.k., detyrohej që të ndërtonte apartamentin sipas kushteve të kontratës. Për shumën 2.000.000 lekë kishte rënë dakord edhe Sh. K., bazuar në kontratën nr. (***), datë 11.08.2007, me objekt shitblerjen e një apartamenti me sip. 41.3 m², me çmim 2.000.000 lekë.

Për apartamentin me sipërfaqe 119 m², të porositur nga personi i lidhur/bashkëshortja e subjektit, Komisioni thelloi hetimin në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës, duke konstatuar se, në bazë të kontratës së shitjes nr. (***), datë 20.03.2018, konfirmohet se shoqëria “(***)” sh.p.k. kalon pronësinë e këtij apartamenti te blerësja Sh. K., kundrejt çmimit 70.000 euro, shumë të cilën, palët kanë deklaruar se e kishin likuiduar totalisht sipas kontratës së sipërmarrjes të lidhur më datë 30.10.2007, ndërmjet shoqërisë së ndërtimit “(***)” sh.p.k. dhe blerëses, sipas deklaratës noteriale nr. (***), datë 30.10.2007, si dhe sipas deklaratës noteriale nr. (***), datë 20.03.2018, që i bashkëngjiten kontratës së shitjes.

Këto deklaratat noteriale rezultuan të ishin lëshuar nga deklaruesja E. M. M.

(përfaqësuar me prokurë nga e motra M. S., që nënshkruan në emër të saj), e cila:

- Më datë 30.10.2007 ka deklaruar se është pronare e truallit ku është ndërtuar pallati nga shoqëria e ndërtimit “(***)Konstruktion” sh.p.k., me të cilën ka një kontratë sipërmarrjeje nr(***), datë 12.04.2004, ku, ndër të tjera, do të përfitonte dhe një apartament banimi me sipërfaqe totale 144 m² (sipërfaqe neto 119 m²). Kjo shtetase deklaroi se, për këtë apartament ka marrë 70.000 euro nga shtetasja Sh. K.
- Më datë 20.03.2018, shtetaset Sh. K. dhe E. M. kanë deklaruar se E. M. ka marrë nga shoqëria e ndërtimit “(***) Konstruktion” sh.p.k. një apartament me sipërfaqe totale 144 m², në objektin 10-katësh, në bazë të kontratës së sipërmarrjes nr. (***), datë 12.04.2004, të cilin ia shet Sh. K., kundrejt vlerës së përgjithshme 70.000 euro, nga të cilat, deri në datën e nënshkrimit të deklaratës (30.10.2007) i janë likuiduar 50.000 euro, ndërsa pjesa tjetër prej 20.000 eurosh do t'i likuidohet brenda muajit nëntor 2007 nga deklaruesja tjetër, znj. Sh. K.

Lidhur me këto fakte, Komisioni kërkoi dhe mori deklarime¹³ nga përfaqësuesi i shoqërisë “(***)” sh.p.k., i cili deklaroi se shumën 2.000.000 lekë e ka marrë nga personi i lidhur në vitin 2006 dhe qëllimi i kësaj shume ishte për t'ia dhënë shtetases E. M. (jo për efekt të kontratës së sipërmarrjes), ndërsa shitjet e njësisve të banimit nga ky subjekt tregtar janë bërë për një çmim rreth 500 euro/m².

Në analizë të deklaratës “Vetting”, të deklarimeve periodike vjetore, si dhe të deklarimeve të subjektit gjatë hetimit administrativ, në raport edhe me dokumentacionin për transaksionet e kryera për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 41.3 m² (pagesa cash 2.000.000 lekë te shoqëria “(*)” sh.p.k.), Komisioni konstatoi se:**

¹³ Shih deklaratën e përfaqësuesit të shoqërisë “(***)” sh.p.k., datë 27.07.2018.

- në momentin e nënshkrimit të kontratës në vitin 2007 nuk rezulton të jenë paguar 2.000.000 lekë *cash* te bashkëpronarët e familjes K.;
- shuma 2.000.000 lekë e përcaktuar në kontratën e sipërmarrjes me shoqërinë “(***)” sh.p.k., për sipërfaqe 119 m², nuk pasqyrojnë as sipërfaqen e saktë të ndërtimit, as koston minimale të lejuar me ligj për ndërtimet civile;
- mandatpagesa pa numër dhe me datë 11.08.2007 nuk rezulton e shoqëruar me asnjë faturë tatimore me TVSH të shoqërisë “(***)” sh.p.k.;
- përfaqësuesi i shoqërisë “(***)” sh.p.k. deklaroi se shumën 2.000.000 lekë e ka marrë nga personi i lidhur në vitin 2006 dhe qëllimi i kësaj shume ishte për t’ia dhënë shtetasës E. M. (*jo për efekt të kontratës së sipërmarrjes në fjalë*).

Nga sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se përbëjnë fiktivitet çmimi dhe mënyra e pagesës në kontratën e shitblerjes nr. (*) , datë 11.08.2007, mes personit të lidhur dhe shtetasve Xh. K., Sh. K., A.(A.) K. dhe M. K. (përfaqësuar me prokurë nga Sh. K.).**

-Gjithashtu, për këtë apartament subjekti i rivlerësimit ka deklaruar **shpenzime për ndryshimin e destinacionit të pasurisë, nga banesë në zyrë noteriale (paguar për këtë 775.355 lekë shoqërisë “(***)” sh.p.k.)**

Lidhur me shpenzimet për ndryshim destinacioni, subjektit të rivlerësimit iu kërkuar deklarime lidhur me pagesat e plota (*cash/bankë*), si dhe dokumentacionin provues të tyre.

Subjekti ka deklaruar se pagesat për ndryshim të destinacionit të apartamentit me sipërfaqe 41.3 m² janë bërë në bazë të situacioneve derdhur pranë financës së shoqërisë “(***)” sh.p.k., sipas:

- mandatarëkëtimin nr. (***) , datë 21.12.2007 - vlera 309.177 lekë;
 - mandatarëkëtimin nr. (***) , datë 06.02.2008 - vlera 459.177 lekë;
- (total 768.354 lekë)**

Sa më sipër, trupi gjykues konstatoi se subjekti i rivlerësimit nuk i ka deklaruar shpenzimet në vitet përkatëse sipas mandateve (DVP 2007 e 2008), si dhe shuma 775.355 lekë, e pasqyruar në aktin e kolaudimit të ndryshimit të destinacionit nga sipërmarrësi “(*)” sh.p.k., si dhe ato nuk rezultuan të shoqëruara me asnjë faturë tatimore me TVSH të kësaj shoqërie, për rrjedhojë përbëjnë fiktivitet vlera dhe mënyra e pagesës së ndryshimit të destinacionit të apartamentit.**

V. Pasuria shtesë, me sipërfaqe 19 m²

Në deklaratën “Vetting” subjekti ka deklaruar se në apartamentin e banimit (*transformuar në njësi shërbimi sipas lejes së ndërtimit nr. 3, datë 26.12.2007, të Bashkisë Durrës*) është bërë shtesë, po këtë vit, me një dhomë dhe një banjë (*sot në proces legalizimi sipas shkresës së ALUIZNI-t Durrës, nr. (***) , datë 17.01.2017*), sipas preventivit të punimeve.

V.1 Komisioni gjatë hetimit administrativ për këtë pasuri konstatoi se:

Me kontratën e sipërmarrjes me shoqërinë sipërmarrëse “(***)” sh.p.k., nr. (***) , datë 18.10.2007, personi i lidhur/bashkëshortja e subjektit ka rënë dakord për rikonstruksionin dhe ndryshimin e destinacionit të përdorimit të apartamentit me sip. 41.3 m², si dhe për ndërtimin e një shtese anësore në objekt, me shpenzimet e palës porositës. Sa u takonte punimeve, ato do të nisin të realizohen vetëm pasi të ishin miratuar lejet përkatëse të sheshit dhe të ndërtimit nga organet kompetente.

Komisioni ka konstatuar se pasuria shtesë sipas parashikimit në kontratë nuk ishte deklaruar nga ana e subjektit të rivlerësimit në vitin 2007, për të cilën ka deklaruar se ishte ekzistuese në momentin e nënshkrimit të kontratës, ndërsa me vendimin nr. 3, datë 26.12.2007 dhe datë 10.01.2008 të KRRT-së Bashkisë Durrës, miratohet vetëm leje ndërtimi për “*ndryshim destinacioni, nga ambient banimi në ambient shërbimi (zyrë)*”, dhe jo edhe për shtesën anësore me subjekt ndërtues shoqërinë sipërmarrëse “(***)” sh.p.k, me afat deri në vitin 2010.

Në vitin 2015 personi i lidhur/bashkëshortja ka nënshkruar deklaratë për përfshirje në procedurat e legalizimit të ndërtimit pa leje dhe/ose shtesës në ndërtimin pa leje, nr. (***), datë 30.01.2015, pranë ALUIZNI-t Durrës, nëpërmjet së cilës kërkon legalizimin e një ndërtimi pa leje, shtesë anësore në ndërtim me leje, të realizuar në vitin 2008. Sipas këtij dokumentacioni, komisioni konstatoi se subjekti nuk e ka deklaruar shtesën e ndërtuar as në deklaratën e pasurive për vitin 2008, dhe as në deklaratën e pasurive të vitit 2015 (referuar të dhënave të deklaramentit të saj pranë ALUIZNI-t Durrës, në vitin 2015).

Pas verifikimit në objekt nga ky institucion, sipas kërkesës së Komisionit, rezultoi se shtesa ishte me sip. 24 m² (*subjekti e deklaroi me sip. 19.63 m²*).

Mbi faktin e ndërtimit të kësaj shtese (*të deklaruar me sip. 19.63 m²*), si dhe kostot e punimeve të kryera për të, subjekti i rivlerësimit shpjegon se ka kryer punime ndërtimi, në bazë të lejeve të ndërtimit, nr. 3, datë 26.12.2007 dhe nr. 5, datë 22.05.1999, të Bashkisë Durrës. Ai rendit zërat e punimeve të ndërtimit që janë kryer në ndërtimin shtesë, për të cilat kishte rënë dakord më parë me shoqërinë “(***)” sh.p.k., në bazë të kontratës së sipërmarrjes nr. (***), datë 18.10.2007. Këto punime në total arritën vlerën 159.177 lekë. Sipas subjektit, ndërtimi shtesë nuk është pasqyruar në skicën që shoqëron aktin e kolaudimit (*të hartuar në përfundim të punimeve të ndërtimit për ndryshim destinacioni të njësisë kryesore*) me pretendimin se, për këtë shtesë nuk kishte dokument pronësie. Me deklaramentimin e bërë, subjekti i rivlerësimit depoziton dhe dokumentacionin përkatës:

- Leje ndërtimi nr. 3, datë 26.12.2007, të KRRT-së Bashkia Durrës;
- Akt-kolaudimi viti 2011, me dokumentacionin teknik dhe ligjor të sipërcituar të bashkëlidhur.

Komisioni, pasi analizoi dokumentacionin, arriti në rezultatin se:

Leja e ndërtimit nr. 3/2007, që paraqet subjekti, miratonte vetëm ndryshimin e destinacionit të ambientit me sip. 41,3 m², nga apartament në zyrë, ndërsa nga skicat e aktit të kolaudimit dallohen dy shtesa anësore në godinë, por që të dyja të pozicionuara në anë të mureve perimetrale të pronës së bërë nga personi i lidhur, pra si zgjatime tek apartamentet fqinje.

Në përfundim, nga analizimi i fakteve dhe provave, trupi gjykues konstatoi se pasurinë ndërtim shtese, me sip. 24 m² ¹⁴, subjekti nuk e ka deklaruar në vitin 2007, sikurse gjatë hetimit administrativ deklaroi se ka qenë ekzistuese që në momentin e nënshkrimit të kontratës së shitblerjes në vitin 2007.

Këtë pasuri subjekti nuk e ka deklaruar as në deklaratën e pasurive për vitin 2008 dhe as në deklaratën e pasurive të vitit 2015, me rastin e nënshkrimit pranë ALUIZNI-t Durrës të deklaratës nr. (***), datë 30.01.2015.

Gjithashtu, subjekti nuk ka deklaruar vlerën e plotë të punimeve edhe për shtesën e ndërtuar, si aset i shtuar, pasi në deklaratën “Vetting” ka deklaruar shpenzime sipas një preventivi për ndryshim destinacioni në shumën 775.355 lekë, ndërsa gjatë hetimit deklaroi shumën 927.531 lekë, ku përfshin edhe vlerën e punimeve për këtë shtesë, që sipas provave të administruara, rezultoi të jetë realizuar pa leje ndërtimi.

¹⁴Sipas konfirmimit të ALUIZNI-t pas kërkesës së Komisionit, shih shkresën nr. (***)prot., datë 20.08.2018.

V.2 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

Mbi konstatimet e Komisionit, në shpjegimet e tij të paraqitura pas kalimit të barrës së provës, por edhe në seancën dëgjimore, ndër të tjera¹⁵, subjekti ka parashtruar se:

“Shtesa në apartamentin e blerë nga familja K. është ndërtuar nga dy shoqëritë: “(***)” sh.p.k dhe “(***)” sh.p.k, për të cilat ka paguar shumat 775.355 lekë dhe 152.176 lekë, total 927.531 lekë. Për këtë shtesë nuk u mor leje shfrytëzimi, sepse banorët e tjerë nuk e kishin përfunduar shtesën në të gjitha katet e këtij seksioni të pallatit, çka pengoi më tej edhe regjistrimin e saj si pronë, duke vijuar me procedurat e legalizimit pranë ALUIZNI-t Durrës, sipas ligjit”. Në përfundim, subjekti deklaroi se: *“Nuk ka kryer pagesë tek anëtarët e familjes K. për apartamentin e blerë, sepse shuma e çmimit të kontratës prej 2.000.000 lekësh i ishte kaluar si pagesë firmës “(***)” sh.p.k”.*

V.3 Arsyetimi ligjor në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

Trupi gjykues, në analizë të pretendimeve të ngritura në parashtrësë, pas kalimit të barrës së provës, por edhe në seancën dëgjimore vlerëson se:

- Mbi deklarin e subjektit, se shumën e çmimit të kontratës së shitblerjes 2.000.000 lekë ia likuidoi familjes K., nëpërmjet dorëzimit të saj te shoqëria “(***)” sh.p.k., e cila në këmbim të kësaj shume do të ndërtonte një apartament me sip. 119 m², trupi gjykues çmon se ky deklarin bie në kundërshtim:

- *Me parashikimin në kontratën për blerjen e apartamentit me sip. 41 m² ku deklarohet se vlera prej 2.000.000 lekësh ishte likuiduar jashtë zyrës noteriale, ndaj shitësve K.;*

- *Konstatimet e fakteve gjatë hetimit administrativ se familja K. nuk kishte porositur asnjë apartament te shoqëria “(***)” sh.p.k.;*

- *Deklarimin e administratorit të shoqërisë “(***)” sh.p.k, i cili mohoi të kishte pasur me subjektin dhe personin e lidhur me të, ndonjë marrëdhënie për ndërtimin e apartamentit dhe se për shumën në fjalë shërbeu vetëm si transportues.*

- Pretendimi i subjektit pas kalimit të barrës së provës, se nga ana e bashkëshortes së tij u mbaruan punimet e ndërtimit, por nuk u realizua regjistrimi i pasurisë shtesë me sip. 19.63 m², pasi nuk u mor leja e shfrytëzimit për të gjithë pallatin, duke qenë se jo të gjithë i kishin mbaruar punimet në të njëjtën kohë, bie në kundërshtim me deklarin e tij gjatë hetimit administrativ, ku deklarohet se shtesa ka qenë ekzistuese që në momentin e blerjes së apartamentit.

- Lidhur me pretendimin e subjektit se shtesa nuk është deklaruar pasi nuk është mbyllur si procedurë hipotekimi dhe gjatë procesit të legalizimit do të jetë e nevojshme të bëhen shpenzime të mëtejshme, si dhe ka ndodhur për të mos pasur përsëritje në deklarime, - trupi gjykues çmon se subjekti nuk ka bërë deklarin të mjaftueshëm për pasurinë shtesë e njësisë zyrë, të poseduar që nga viti 2007, si dhe shpjegimet e tij nuk janë bindëse.

- Pretendimi i subjektit se pasuria shtesë është ndërtuar me lejen/vendimin nr. 5, datë 22.05.1999, të KKRT-së Bashkia Durrës. si për të gjithë banorët në pallatin e ndodhur në Lagjen nr. (***), Rr. “(***)”, pll. (***), Durrës, bie në kundërshtim me deklarin e personit

¹⁵Refero në parashtrimet e subjektit në dosje.

të lidhur në vitin 2015 pranë ALUIZN-it, që e evidenton shtesën e apartamentit si ndërtim pa leje, të realizuar në vitin 2008.

Në kushtet që subjekti i rivlerësimit nuk depozitoi asnjë provë për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, trupi gjykues çmon se:

Shpenzimet e deklaruara: Në vlerën 2.000.000 lekë për kalim pronësie dhe në vlerën 927.531 lekë për punime shtesë, pra në total vlera prej 2.927.531 lekësh, nuk pasqyrojnë vlerën reale të paguar për krijimin e pasurisë apartament banimi 41.3 m², dhe shtesën 24 m², pasi:

- *Përbën fiktivitet çmimi dhe mënyra e pagesës në kontratën e shitblerjes, me aplikimin e çmimit real të kalimit të pronësisë;*

- *Përbën fiktivitet vlera dhe mënyra e pagesës së ndryshimit të destinacionit dhe e ndërtimit përfundimtar të shtesës anësore;*

- *Jemi përpara një mosdeklarimi të mjaftueshëm të pasurisë së plotë në përdorim dhe shpenzimeve reale të kryera për ndryshim destinacioni;*

- *Si dhe konstatohen punime ndërtimi shtesë nga subjekti dhe personi i lidhur, të pamiratuara nga bashkia në lejen e ndërtimit, të realizuara gjatë ekzekutimit të lejes së ndërtimit për ndryshim destinacioni, të cilat nuk deklarohen dhe nuk pasqyrohen as në rastin e inspektimit dhe kolaudimit të objektit, me qëllim që nga administrata të miratohej dhe regjistrohej vetëm ndryshimi i destinacionit.*

VI. Pasuria tokë (arë) 4.000 m², fituar¹⁶ si anëtar i familjes bujqësore, dhe si ish-punonjës i Ndërmarrjes Bujqësore Spitallë, sektori Fllakë i Durrësit – AMTP-së, nr.(***).

VI.1 Faktet e konstatuara nga Komisioni, si dhe provat e administruara për vërtetimin e tyre gjatë hetimit administrativ

Në deklaratën “Vetting”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se e ka përfitur pasurinë “tokë arë” me sip. 4.000 m², si anëtar i familjes bujqësore në bazë të ligjit nr. 7051, datë 19.07.1991, “Për tokën”, dhe si ish-punonjës i Ndërmarrjes Bujqësore Spitallë, sektori Fllakë, Durrës, në bazë të aktit të marrjes në përdorim dhe aktit të marrjes në pronësi nr. (***)/1996 (AMTP).

Në kushtet kur Komisioni konstatoi se, në deklarimin e pasurisë së vitit 2003, subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar këtë pasuri si një *pasuri të dhuruar nga prindërit*, por pa referuar të dhënat e aktit të dhurimit, zgjeroi dhe thelloi hetimin mbi origjinën e kësaj pasurie në pronësi të prindërve dhurues, zhvillimin e mëvonshëm të pasurisë, si dhe gjendjen aktuale të kësaj prone.

¹⁶Fitimi i pronësisë mbi tokat bujqësore mund të realizohej vetëm në plotësim dhe zbatim të kriterëve të sanksionuara në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991, “Për tokën” (i ndryshuar), ligjit nr. 8053, datë 21.12.1995, “Për kalimin në pronësi, pa shpërbim, të tokës bujqësore” dhe ligjit nr. 8337, datë 30.04.1998, “Për kalimin në pronësi të tokës bujqësore, pyjore, livadheve dhe kullotave”, si dhe akteve nënligjore në zbatim të tyre, përfshirë edhe VKM-të në zbatim të ligjit për shkrirjen e ndërmarrjeve bujqësore.

Në thelb të këtyre akteve qëndron interesi parësor i shtetit për të pajisur me tokë bujqësore:

1. *Familjet bujqësore, që figurojnë si të tilla deri në datën 01.08.1991.*

2. Në radhë të dytë, të pajisë me tokë personelin teknik dhe administrativ të NB-ve apo të kthejë pjesën e mbetur te personat që e kanë dorëzuar si kontribut në themelimin e kooperativave bujqësore apo NB – apo trashëgimtarëve të tyre (në kufijtë ekzistues – brenda mundësive).

Pra, kanë të drejtë që të pajisen me tokë bujqësore themeluesit e kooperativave bujqësore dhe të ndërmarrjeve bujqësore me banim në fshat deri në 01.08.1991; punonjësit e ndërmarrjeve bujqësore dhe punonjësit në shtet dhe që kanë banim në fshat deri në tetor të vitit 1992; si dhe në fund, toka që mbetej në dispozicion, u jepej ish-pronarëve, me tokat e të cilëve janë themeluar kooperativat dhe ndërmarrjet bujqësore deri në limitin e tokës së dhënë dhe, kur kjo nuk ishte e mundur, deri në limitin e sipërfaqes së tokës në dispozicion.

Gjithashtu, Komisioni i kërkoi subjektin dorëzimin e aktit të dhurimit së bashku me dokumentacionin shoqëruar përkatës të pronësisë, para dhe pas dhurimit.

Për sa më sipër, subjekti ka dhënë shpjegimet e tij, nëpërmjet të cilave pretendohet se:

Z. B. H. (*babai i subjektit të rivlerësimit*), përfiton tokë nga ligji nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për tokën”, si kryetar i familjes bujqësore, duke fituar sip. 4.000 m² tokë. Ai i kërkoi komisionit të ndarjes së tokës në fshatin Bishkamëz që AMTP-ja të kalonte direkt në emër të të birit, z. Bujar Hoti. “*Kjo formë e kalimit të kësaj sipërfaqeje, është përshkruar nga ana ime (e subjektit) si dhurim i pasurisë*” - shprehet subjekti i rivlerësimit. Ndërkohë, me shkresën nr. (***) prot., datë 23.04.2018, të Këshillit të Qarkut të Prefektura¹⁷ Durrës konfirmohet se, sipas formularit nr. 6 (tokë në përdorim) dhe në pasqyrën e mbajtur sipas Udhëzimit të Ministrit të Bujqësisë nr. 106, datë 23.02.1996, që i përket ish-sektorit Fllakë (Bisht - Kamëz), sot njësi administrative (*ish-komuna*) Katund i Ri, Bujar Hoti ka përfituar si ish -punonjës i Ndërmarrjes Bujqësore, sektori Fllakë (Bisht - Kamëz), një parcelë toke të llojit arë, me sip. totale 4.000 m² (kjo rrethanë pranohet nga subjekti i rivlerësimit me nënshkrimin e tij në formularin nr. 6 se ka marrë në dorëzim këtë parcelë si ish- punonjës i Ndërmarrjes Bujqësore).

- Me shkresën me nr. (***)prot., datë 31.01.2018, të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile rezultoi se, më datë 01.08.1991, në trugun familjar të personit tjetër të lidhur, z. B. H., ishin 4 anëtarë: subjekti i rivlerësimit, babai (B. H. - kryefamiljar), nëna (P.H.) dhe gjyshja (nëna e B. H.); këta janë zhvendosur nga fshati Qerret në qytetin e Durrësit që në datën 26.10.1990 (ku e kanë edhe sot regjistrin e gjendjes civile). Në këto kushte, Komisioni konstatoi se nuk plotësohej kushti i banimit në fshat i kësaj familjeje për t’u pajisur me tokë si familje bujqësore nga kooperativa bujqësore e fshatit Qerret.

- Me shkresën e prokurorisë së Lushnjës, datë 26.10.2016, konfirmohet se subjekti i rivlerësimit ka punuar si hetues në Hetuesinë e Lushnjës që nga data 1 dhjetor 1986.

- Me shkresën e Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Durrës, nr. (***) prot., datë 02.06.2018, konfirmohet se personi tjetër i lidhur, babai i subjektit, z. B. H., ka qenë drejtor i Ndërmarrjes Bujqësore të Spitallë, Durrës.

Me shkresën nr. (***) prot., datë 17.04.2018, të ZVRPP-së Durrës (*dhe materialet shkresore bashkëlidhur*), si dhe me shkresën nr. (***) prot., datë 23.04.2018, të Këshillit të Qarkut të Prefekturës Durrës (*dhe materialet shkresore bashkëlidhur*) konfirmohet se personi tjetër i lidhur, babai i subjektit të rivlerësimit, ka përfituar sip. 12.600 m² tokë sipas të dhënave të mëposhtme:

1. Tokë me sip. 2.000 m² sipas AMTP-së, nr. (***), datë 05.06.1996, në Shkozë të Durrësit si ish-drejtor i Ndërmarrjes Bujqësore;
2. Parcela nr. (***) me sip. 2.300 m² arë, nga të cilat 200 m² truall/Qerret;
3. Parcela nr. (***) me sip. 2.000 m² arë/Qerret;
4. Parcela nr. (***) me sip. 6.300 m² arë/Qerret.

Me vendim të Këshillit Bashkiak, nr. 3, datë 01.08.1996, rezultoi se babai i subjektit të rivlerësimit kishte fituar statusin si i pastrehë, ndërsa në vitin 2003 kishte privatizuar një apartament banimi me sip. 86 m², ndodhur në Lagjen nr. (***), Rr. “(***)” Durrës, -me financim nga Enti Kombëtar i Banesave, Drejtoria Rajonale Durrës. Ky privatizim do të ishte i mundur, vetëm nëse nuk je subjekt i ndalimeve të parashikuara në nenin 23 të ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore” (me ndryshimet) ... “*nuk përfitojnë*

¹⁷Shih shkresën nr. (***)prot., datë 23.04.2018, të Këshillit të Qarkut të Prefekturës Durrës.

edhe fshatarët që kanë marrë leje banimi në qytet pas datës 31.07.1991 dhe që kanë përfituar nga ligji "Për tokën".

Për sa më sipër, rezulton i provuar fakti se personi i lidhur, babai i subjektit, ka përfituar një sip. 10.600 m² tokë tjetër në fshatin Qerret dhe sip. 2.000 m² në Shkozet të Durrësit (*këtë si ish-drejtor i kësaj NB-je*), duke mos e pasur më tej të drejtën për të përfituar tokë edhe nga ish-ndërmarrja bujqësore Bish - Kamëz.

Në analizë të provave të mësipërme, Komisionit i rezultoi se as babai i subjektit nuk ishte pajisur me tokë me sip. 4000 m² në ndërmarrjen bujqësore Spitallë, sektori Fllakë, pasi nuk plotësonte asnjë nga kriteret ligjore për t'u pajisur me tokë nga kjo ndërmarrje dhe, për pasojë, nuk mund t'ia dhuronte të birit këtë pasuri në rrethanat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit.

Në kuadër të hetimit administrativ, referuar kriterëve ligjore të përfitimit të kësaj pasurie, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit të rivlerësimit, pasi i rezultuan dyshime të arsyeshme se ai nuk kishte një titull të ligjshëm për përfitimin e saj si subjekt i ligjit "Për tokën".

VI.2 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

Pas kalimit të barrës së provës dhe në seancë dëgjimore, subjekti ka shprehur qëndrimin e tij nëpërmjet shpjegimeve mbi konstatimet e Komisionit. Subjekti i rivlerësimit ka parashtruar, ndër të tjera, se:

- Deklarimi i kësaj pasurie prej tij në vitin 2003, si një pasuri e dhuruar nga prindërit, nuk kishte të bënte me një akt shkresor, por ishte dhuruar në kuptimin *faktik*. Prona ishte përfituar dhe kaluar në pronësinë e tij, për shkak se në periudhën e ndarjes së tokës ishte anëtar i familjes bujqësore, e cila përbëhej nga 4 anëtarë.

- Familja e tij kishte banuar në fshatin Qerret, komuna e Katundit të Ri, që pas viteve '45 e deri në vitin 1990, sipas të dhënave të gjendjes civile, por *de facto* kjo familje bujqësore ka vazhduar të jetojë dhe mbas viteve '90 në banesën e tyre.

Sipas shkresës me nr. (***) prot., të komunës Katundi i Ri, norma e sipërfaqes së tokës për frymë në fshatin Qerret ishte 4.200 m² për frymë. Subjekti parashtron se familja e tij ka banuar në këtë fshat që nga krijimi i kooperativës e deri në vitin 1990, *me gjendje civile dhe de facto*, edhe disa vite më vonë.

Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar dhe pretenduar se është pjesë e një familjeje bujqësore, sipas parashikimeve të ligjit nr. 7501 "Për tokën", pasi anëtarët e trungut të tij familjar kanë banuar *de facto* në fshatin Qerret (*në banesën e tyre të ndërtuar nga bashkëfamiljarët dhe nga të afërm të tjerë*), duke qenë anëtarë në kooperativë, duke pasur të drejtën e pajisjes me tokë bujqësore sipas normës 4.200 m² tokë për frymë, që raportuar me numrin e anëtarëve dhe sipërfaqen e tokës së përfituar, u plotësua me tokën me sipërfaqe 4.000 m², të cilën babai i subjektit, në bashkëpunim me komisionin e ndarjes së tokës e shënoi drejtpërdrejt në emër të të birit.

Në vijim, subjekti plotëson shpjegimet e tij një tjetër argument, mbi të drejtën e përfitimit të tokës me sipërfaqe 4.000 m², duke parashtruar faktin se ka qenë punonjës¹⁸ i ndërmarrjes bujqësore gjatë kohës kur kryente stazhin parauniversitar 1981-1982 (*për një periudhë 10 mujore*), shkak për të cilin pretendon se i takonte të përfitonte tokë nga parcelat e ndërmarrjes si ish-punonjës i saj.

¹⁸ Shih dokumentin akt-verifikimi të Sigurimeve Shoqërore për vjetërsi në punë datë 22.08.2018.

VI.3 Arsyetimi ligjor në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

Trupi gjykues, në analizë të pretendimeve të ngritura në parashtrësë, pas kalimit të barrës provës, por edhe në seancën dëgjimore vlerëson se:

Lidhur me pretendimin e subjektit se kjo pasuri është përfituar dhe ka kaluar në pronësinë e tij, për shkak se në periudhën e ndarjes së tokës kishte qenë anëtar i familjes bujqësore, e cila, *de facto* ka vazhduar të jetojë dhe mbas viteve '90 në banesën e saj, trupi gjykues vlerëson se ky pretendim bie në kundërshtim me kriteret ligjore të parashikuara nga ligji nr. 7501, datë 19.07.1991, "Për tokën", pasi, sikurse rezulton e mbështetur në prova (*dokumentacioni i gjendjes civile, Bashkia Durrës*), familja me kryefamiljar z. B. H. është vendosur në qytetin e Durrësit në vitin 1990. Në referim të datës së hyrjes në fuqi të ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991, "Për tokën", përfitojnë nga ky ligj ato familje bujqësore që janë anëtare të kooperativës dhe banojnë në fshat të paktën deri më 01.08.1991. Kjo rrethanë e përjashton subjektin dhe familjen e tij që të jenë familje bujqësore, pasi nuk kanë qenë anëtare të ndonjë kooperative dhe as me banim në fshat¹⁹, në datën e referimit ligjor për prodhimet e efekteve të tij, që nuk janë me efekte prapavepruese.

Në këtë drejtim, subjekti ka deklaruar se zhvendosja e tij në qytet dhe përfitimi i apartamentit për strehim në qytet ishte si rezultat i së drejtës që gëzonte babai i tij si drejtor i një ndërmarrjeje bujqësore. Mbështetur në këto deklarime, rezulton se babai i subjektit nuk ka qenë anëtar i kooperativës së fshatit Qerret të Durrësit, ku ka përfituar tokë.

Lidhur me pretendimin e subjektit²⁰, se kjo pasuri është përfituar edhe si ish-punonjës i ndërmarrjes bujqësore, trupi gjykues çmon se akt-verifikimi i Sigurimeve Shoqërore për vjetërsi në punë, datë 22.08.2018, nuk është dokumenti ligjor që vërteton vjetërsinë në punë dhe as punën e kryer efektivisht. Megjithatë, nga akti i verifikimit dhe nga deklarimi i subjektit, rezulton se ai ka kryer një stazh pune prodhuese 10-mujore, si pjesë e programeve të kohës në shkollë, apo të pranimit në detyra shtetërore të kuadrove. Për këtë periudhë, stazhierët nuk konsideroheshin punëtorë të mirëfilltë të asaj ndërmarrjeje bujqësore. Referuar të dhënave në aktin e verifikimit, rezulton që subjekti nuk kishte asnjë të drejtë që të pajisej me tokë bujqësore nga toka e ndërmarrjes, ku ai kishte punuar 10 vite më parë për 10 muaj. Subjekti i rivlerësimit nuk mund të ishte edhe subjekt i ligjit për shkrirjen e ndërmarrjeve bujqësore dhe as i ligjit për tokën, për shkak se në bazë të vendimit nr. 452, datë 17.10.1992 "Për ristrukturimin e ndërmarrjeve bujqësore" (i ndryshuar), pikat 2, 3 dhe 4: *Toka e një ndërmarrjeje bujqësore kalonte në pronësi të punëtorëve nga qyteti që ishin efektivisht në punë në ndërmarrje bujqësore, ose banorë të territorit të saj apo themelues të kooperativës, me gjithë ndryshimet familjare deri më datë 1 tetor të vitit 1992.*

Gjithashtu, lidhur me këtë pretendim, trupit gjykues i rezulton se subjekti i rivlerësimit ka nënshkruar marrjen e parcelës në dorëzim në Formularin 6 në cilësinë e punëtorit të ndërmarrjes që figuronte si i tillë më datë 31 tetor 1992, dhe në asnjë rast nuk ka kundërshtuar këtë nënshkrim.

Sikurse referohet më sipër, ligji nr. 7501, datë 19.07.1991, "Për tokën", e lidh statusin e familjes bujqësore me vendbanimin në fshat deri në një datë të caktuar dhe anëtarësinë e tyre në një njësi organizative si kooperativë bujqësore (*rezultat i bashkimit vullnetar i të gjitha aseteve me natyrë bujqësore*). Toka fillimisht jepej në përdorim, madje me sanksione në rast të

¹⁹ Minimalisht në rrethana të dyshimta.

²⁰ Gjatë hetimit administrativ, por edhe në parashtrimet pas barrës së provës.

mospërdorimit për një afat të caktuar sipas destinacionit (që, në fakt, është edhe koncepti i një reforme agrare).

Banimi *de facto* i prindërve, që pohon²¹ subjekti, nuk shërben si shkak për ta konsideruar babain dhe nënën e tij si anëtarë të familjes bujqësore dhe, aq më pak, të përfshijnë në këtë status edhe subjektin, meqenëse ky i fundit figuronte në të njëjtin trung familjar me ta.

Por, nga hetimi administrativ rezultoi se subjekti ishte me punë në Hetuesinë e Lushnjës që nga viti 1986 dhe më pas në Prokurori, para, gjatë dhe pas periudhës së referuar, ka e përjashton atë nga e drejta e përfitimit të tokave bujqësore, në bazë të legjislacionit të reformës agrare.

Në përfundim, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit nuk ka një titull të ligjshëm të përfitimit të pasurisë tokë arë me sip. 4.000 m², si dhe vlerëson se veprimet e paligjshme, duke mos përmbushur asnjë prej kriterëve objektive dhe subjektive për t'u pajisur me tokë bujqësore, cenojnë figurën e prokurorit.

VII Pasuria autoveturë e tipit “Nissan - Juke”, me targë (*) blerë me vlerën 16.900 euro.**

Burimi: Blerë me të ardhurat nga shitja e automjetit tip “Peugeot”, me targa (***), prej 5.000 eurosh, sipas kontratës së shitblerjes nr. (***) rep., nr. (***)kol., dhe 1.900 euro nga kursimet dhe 10.000 euro janë marrë kredi pranë “ProCredit Bank” sh.a., sipas kontratës së datës 21.07.2012, kredi e cila është shlyer brenda afatit të kontratës. Vlera: 16.900 euro. Pjesa takuese: 100 %.

VII.1 Faktet e konstatuara, nga Komisioni si dhe provat e administruara për vërtetimin e tyre gjatë hetimit administrativ:

- Në bazë të kontratës së datës 23.07.2012 konfirmohet se personi i lidhur ka blerë nga shoqëria “(***)” automjetin tip “Nissan - Juke” shoqëruar me faturën tatimore nr. 33, datë 23.07.2012, për çmimin 16.900 euro ose 2.318.849 lekë (me TVSH).

Duke analizuar deklaratimet periodike mbi çmimin e kësaj pasurie, Komisioni konstatoi se në deklaratën e vitit 2012, në cilësinë e personit i lidhur, bashkëshortja kishte deklaruar: “Blerë autoveturë ‘Nissan – Juke’, nga salloni ‘(***)’, në vlerën 16.900 euro, nga e cila janë likuiduar 2.285 euro, sipas kontratës datë 23.07.2012”, dhe nuk rezultonte deklarimi si detyrim i mbetur shuma e papaguar në atë vit, pra $16.900 - 2.285 = 14.615$ euro.

- Për sa u konstatua, Komisioni i kërkoi deklarime subjekti të rivlerësimit, i cili shpjegoi se:
- Shuma monetare prej 16.900 eurosh për blerjen e autoveturës tip ‘Nissan-Juke’, viti 2012, benzinë + gaz, shoqëruar me faturën tatimore nr. 33, datë 23.07.2012, të shoqërisë ‘(***)’ sh.p.k. ndaj blerëses A. H., dhe pagesa është kryer/ derdhur në llogarinë bankare të ‘(***)’ sh.p.k. në dy këste, përkatësisht;

- Në datën 23 korrik 2012 është derdhur shuma prej 6.900 eurosh pranë “Credis Bank”, dega Laprakë, shoqëruar me mandatpagese (bankare) datë 27.02.2013, veprim në sportel, në favor të shoqërisë “(***)” sh.p.k., me nr. llogarie (***), “Credins Bank”, përshkrimi: “Derdhje, A. H., likuidim i faturës tatimore nr. 33, datë 23.07.2012”, shuma 6.900 euro;

- Më datë 1 gusht 2012 është derdhur pjesa tjetër e shumës prej 10.000 eurosh pranë “ProCredit Bank”, shoqëruar me dokumentin me urdhër transfertë (i brendshëm - banka ProCredit Bank), nr(***), datë 01.08.2012, përshkrimi: “A. H. - pagesë për blerje makine Nisan - Juke nga (***)”, shuma 10.000 euro. Ky deklarim u shoqërua edhe me dokumentacion,

²¹ Refero parashtrimet e subjektit pas kalimit të barrës së provës.

kontratë e blerjes së automjetit, datë 23.07.2012, fatura tatimore, si dhe faturat bankare të likuidimit të shumës totale të shitjes.

Pas analizimit të dokumentacionit të depozituar nga subjekti i rivlerësimit, Komisionit i rezulton se pagesa e shumës prej 6.900 eurosh pranë “Credis Bank”, shoqëruar me mandatpagese (bankare) është likuiduar më datë 27.02.2013, dhe jo në vitin 2012, për pasojë rezultuan mospërputhje lidhur me deklarin e pagesave në raport me dokumentacionin e depozituar.

Si rezultat i mospërputhjeve të pagesave, Komisioni i kaloi barrën e provës lidhur me mosdeklarimin me saktësi dhe vërtetësi deklarin në DVP-në e vitit 2012, në lidhje me pasqyrimin si detyrim i mbetur vlerën prej 6.900 eurosh, si dhe nuk rezultonte e deklaruar asnjë ndryshim pasuror, sa i takonte ***shumës së paguar në vitin 2013 (6.900 euro) për rrjedhojë, as burimin e ligjshëm të të ardhurave për këtë pagesë.***

VII.2 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

Mbi konstatimet e Komisionit, në shpjegimet e tij, të paraqitura pas kalimit të barrës së provës, por edhe në seancën dëgjimore, ndër të tjera ²², ka parashtruar se;

Në lidhje me deklarin për vitin 2012 për automjetin “Nissan Juke”, nga ana e tij ishte një *lapsus* në pasqyrimin e vlerës, si dhe është lënë në mes. Megjithatë, pavarësisht gabimit material, po ti referohemi dokumentacionit bashkëlidhur deklarin, përkatësisht mandatë pagesës, reflektohet shuma reale e paguar 16.900 euro, mbi bazën e këtyre dokumenteve vërtetohet pagesa e saktë e cila është pjesë përbërëse e deklaruar në vitin 2013.

Për këto arsye, subjekti i qëndron shpjegimeve dhe provave të pagesës për automjetin tip “Nissan Juke” blerë siç ishte sqaruar dhe gjatë fazës së hetimit.

VII.3 Arsyetimi ligjor në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

Trupi gjykues, në analizë të pretendimeve të ngritura në parashtrësë, pas kalimit të barrës provës, por edhe në seancën dëgjimore vlerëson se:

Pas analizimit deklarimeve në deklaratën periodike të vitit 2012, të dokumentacionit të depozituar nga subjekti i rivlerësimit, Komisionit i rezulton se pagesa e shumës prej 6.900 eurosh pranë “Credis Bank”, shoqëruar me mandatpagesë (bankare), është likuiduar më datë 27.02.2013, dhe jo në vitin 2012, sikurse pretendohet nga subjekti i rivlerësimit.

Edhe pse subjekti i rivlerësimit i konsideron si gabime materiale, dhe realiteti i pagesave është ai i deklaruar gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues çmon se deklarimi me saktësi i pasurive dhe gjendjes së tyre është detyrim ligjor në bazë të ligjit nr. 9049/2003 dhe të ndryshimeve të tij, për rrjedhojë, çmon se subjekti i rivlerësimit nuk ka bërë deklarime të sakta në deklarin vjetor të pasurisë së vitit 2012, si kryer deklarime të pamjaftueshme lidhur me ndryshimin e pasurisë, si dhe të detyrimeve në DVP/2012 dhe DVP/2013, për pasojë edhe në “Deklaratën e Pasurisë, Vetting” 2017.

²²Refero parashtrimet e subjektit në dosje.

VIII Konstatime të tjera

- Gjatë hetimit administrativ, Komisioni konstatoi se në “Deklaratën e Pasurisë, Vettig” së vitit 2007 janë deklaruar të ardhura nga shitja e autovecurës tip “Opel Astra”, prodhim i vitit 1995, sipas deklarimeve të mëparshme viti 2005, në pronësi të bashkëshortes, znj. A. H.

- Në kushtet kur DPSHTRR-ja me shkresat nr. (***) prot., datë 29.01.2018, nr. (***)prot., datë 06.02.2018, shkresën nr. (***)prot., datë 06.02.2018, konfirmon se, nuk rezulton asnjë transaksion që të jetë regjistruar që të ketë për objekt blerjen dhe më pas rishitjen e një automjeti tip veturë, e markës “Opel Astra”, prodhim i vitit 1995.

Lidhur me këtë konstatim, Komisioni i kërkoi deklarime subjektivit të rivlerësimit i cili deklaroi se me kontratën noteriale nr. (***) , datë 08.02.2005, personi i lidhur kishte blerë nga shitësi z. A. C. automjetin “Opel Astra”, kundrejt çmimit me 500.000 lekë. Pagesa është kryer *cash*, jashtë zyrës noteriale. Me kontratën noteriale nr. (***) , datë 24.12.2007, znj. A. H. ka shitur tek I. L., automjetin kundrejt çmimit 500.000 lekë. Çmimi është tërhequr *cash* jashtë zyrës noteriale. Gjithashtu, subjekti bashkëlidh kontratat e sipërcituara.

5. Në vlerësim të fakteve dhe rrethanave, Komisioni i kaloi barrë prove në kushtet kur i rezultoi se personi i lidhur nuk e kishte deklaruar këtë automjet si blerje në DVP-në e vitit 2005, kishte bërë fshehje të pasurisë së luajtshme të fituar, si dhe mosdeklarim të burimit të ligjshëm për fitimin e saj, në vitin 2005 dhe 2007.

VIII.1 Qëndrimi i subjektivit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

Mbi konstatimet e Komisionit, në shpjegimet e tij, të paraqitura pas kalimit të barrës së provës, por edhe në seancën dëgjimore, ndër të tjera²³ ka parashtruar se:

- Autoveutura në fjalë ishte blerë nga bashkëshortja ime, znj. A. H., nëpërmjet kontratës noteriale nr. (***) , datë 08.02.2005, blerja e secilës për shkak të nxitimit (mungesë vëmendje) nuk është bërë pjesë e deklaratës për vitin 2005. Pavarësisht këtij veprimi të nxituar nga ana e tij është bërë pasqyrimi dhe deklarimi në momentin e shitjes sikurse rezultoi nga deklarimi i vitit 2007.

- Deklarimi i veprimit juridik të shitjes së automjetit, ndonëse nuk është bërë deklarimi i blerjes për vitin 2005, vërteton se veprimi i mosdeklarimit në vitin 2005, nuk ka qenë me dashje, për më tepër që nuk ka pasur për qëllim fshehjen e të ardhura financiare, duke vënë në dukje se deklarimi i shitjes prezumon edhe veprimin e blerjes, për më tepër që në këtë deklarim për vitin 2007, është bashkëngjitur edhe kontrata e blerjes së vitit 2005. Fakti që shitja është deklaruar rregullisht pranë organit përkatës tregon se nuk ka qenë qëllimi për fshehje të pasurisë.

VIII.2 Arsyetimi ligjor në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

Trupi gjykues, në analizë të pretendimeve të ngritura në parashtrësë, pas kalimit të barrës provës, por edhe në seancën dëgjimore vlerëson se:

Pretendimet e subjektivit për mungesë vëmendjeje, lapsuse, nuk mund të çmohen si shkaqe ligjore për të mos deklaruar me vërtetësi e saktësi pasuritë, për pasojë sikurse rezultoi i provuar, pasuria automjet e tipit “Opel Astra” nuk është deklaruar as si blerje në DVP-në e vitit 2005, për pasojë rezultoi mosdeklarim i burimit të ligjshëm për fitimin e saj, në vitin 2005 dhe 2007, dhe i çmon ato si mospërbushje të detyrimi ligjor që rrjedh nga ligji nr. 9049/2003 dhe të ndryshimeve të tij.

²³Refero parashtrimet e subjektivit në dosje.

Për shkak se të ardhurat e siguruara nga shitja e këtij automjeti janë deklaruar si burim i krijimit të asetit të luajtshëm automjet tip “Peugeot”, me targa () , dhe shitja e këtij të fundit deklarohet si burim për automjetin tip “Nissan-Juke” në deklaratën “Vetting”, Komisioni vlerëson se për këtë pasuri subjekti ka bërë deklaram të pamjaftueshëm të burimit të ligjshëm të tij .**

Rezultatet e analizës financiare²⁴

Komisioni për vlerësimin e faktit nëse subjekti i rivlerësimit kishte aftësi paguese për likuidimin e pasurive, në momentet e pagesave të kryera, kreu për llogaritjet financiare, në raport me të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur, investimet dhe shpenzimet e kryera. Nga analizimi i burimeve të ligjshme të të ardhurave të subjektit të rivlerësimit, Komisionit i rezultoi se subjekti i rivlerësimit rezulton me bilanc negativ për vitet 2004, 2007 e 2010, për të realizuar investimet e pasurive të deklaruara në Deklaratën-Vetting.

Viti 2004

-Lidhur me mjaftueshmërinë e të ardhurave për pagesën e këstit të parë prej 20.000 eurosh, të pasurisë apartament me sip. 157 m², në qytetin Durrës, pall. (***) , investim i subjektit në vitin 2004, situata financiare sipas tabelës së mëposhtme pasqyrore një bilanc negativ në vlerën minus 2.580.848 lekë.

| ANALIZA FINANCIARE | Viti 2004 |
|---|--------------------|
| Të ardhurat | 2.927.550 |
| - Nga paga e tij | 1.355.582 |
| ➤ Nga biznesi noterisë së bashkëshortes | 1.571.968 |
| Pasuritë | 10.316.530 |
| ➤ Apartament banimi (50.000 euro x 126.74 lekë ²⁵ /euro) (sipas kontratës së sipërmarrjes 70.000 euro) | 6.337.000 |
| ➤ Likuiduar 20.000 euro <i>cash</i> (sipas kontratës së sipërmarrjes) | 2.534.800 |
| ➤ Shuar likuiditetet në fund të vitit në bankë | 1.444.730 |
| Detyrimet | 6.013.050 |
| ➤ Kredi bankare (48.000 euro) | 6.083.520 |
| ➤ Paguar këst kredie (principali) | - 70.470 |
| Pasuritë neto | 4.303.480 |
| Shpenzime | 1.204.918 |
| ➤ Shpenzime jetike sipas ILDKPKI-së | 642.857 |
| ➤ Paguar këst për interes kredie | 187.061 |
| ➤ Pagesë për blerjen e pjesës së apartamentit prindërve | 100.000 |
| ➤ Për shkollimin e djalit | 275.000 |
| DIFERENCA | - 2.580.848 |

- Mbi analizën financiare, Komisioni i mundësoi subjektit të rivlerësimit metodologjinë e përdorur si dhe e informoi subjektin e rivlerësimit mbi konstatimin, se nuk kishte deklaruar gjendjen e llogarive bankare në fund të vitit 2004, për të cilën Komisioni u bazua në dokumentacionin e ardhur nga bankat, nga ku rezulton se gjendja e llogarive në fund të vitit 2004, ishte shuma prej 1.444.730 (një milion e katërqind e dyzet e katër mijë e shtatëqind e

²⁴ a. Deklarimet e bëra ndër vite nga ana e subjektit të rivlerësimit, pranë ILDKPKI-së; b- Provat shkresore të administruara nga ana e ILDKPKI-së; c- Dokumentacioni i dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit; Deklarimet e bëra nga ana e subjektit të rivlerësimit, përmes postës elektronike, gjatë hetimit administrativ të kryer nga ana e Komisionit; e- Provat shkresore të administruara nga Komisioni, nga institucione publike dhe private; f- Analizën financiare të bërë nga ana e Komisionit; g- Çdo dokument që përbën mjet prove sipas nenit 49 të ligjit nr. 84/2016;

²⁵Likuidimet në euro janë vlerësuar me 126.74 (Kursi mesatar i këmbimit të vitit 2004, marrë nga arkiva e BSH).

tridhjetë) lekësh, nga të cilat gjendja në llogarinë e kursimeve në “NBG Bank” është 10.014 (dhjetë mijë e katërbëdhjetë) euro.

- Në përlllogaritjet e analizës financiare, Komisioni mbajti në konsideratë faktin e pagesës prej 20.000 (njëzet mijë) eurosh, si dhe se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në asnjë vit gjendje *cash* të likuiditeteve, dhe as në deklaratën “Vetting”, (*me përjashtim të vitit 2006 vlerën 600.000 lekë*), të cilën e konfirmoi edhe gjatë hetimit administrativ, deklarim ky që përben provë në kuptim të nenit 49, pika “b” të ligjit nr. 84/2016.

- Mbi përlllogaritjet e Komisionit, subjekti i rivlerësimit me anë të ekspertit financiar ka kundërshtuar pagesën në shumën prej 20.000 (njëzet mijë) eurosh të kështit të parë të kontratës së sipërmarrjes nr. (***) , datë 25.06.2004. Lidhur me këtë pretendim, sikurse arsyetoi më lart për këtë pasuri, trupi gjykues në çmuarje të fakteve dhe provave sa më sipër, vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit se nuk e ka kryer pagesën e kështit të parë në vlerën prej 20.000 eurosh në prani të noteres, mbetet i pambështetur në prova, si dhe bie në kundërshtim me ato të deklaruara prej tij më parë. **Për pasojë, mbeten të pandryshuara përlllogaritjet e Komisionit në analizën e kryer, që reflekton mungesë të burimeve të ligjshme për pagesën e kështit të parë prej 20.000 eurosh dhe mosdeklarim të tij.**

Viti 2007

- **Përlllogaritjet financiare të Komisionit** lidhur me mjaftueshmërinë e të ardhurave vjetore 2007 të ligjshme për të blerë të gjitha pasuritë dhe për të kryer shpenzimet e sipërcituara, pasqyrohen në tabelën si më poshtë:

| Nr. | ANALIZA FINANCIARE | Viti 2007 |
|-------|--|------------|
| 1 | Te ardhurat | 4.816.000 |
| | ➤ Paga e tij | 1.316.000 |
| | ➤ Nga biznesi i bashkëshortes (zyrë noteriale) | 3.000.000 |
| | ➤ Shitur automjeti i tipit "Opel Astra" 24.12.2007 | 500.000 |
| 2 | Pasuritë | 15.408.573 |
| | ➤ Apartament, sip. 41.03m ² , datë 11.08.2007 | 2.000.000 |
| | ➤ Shtesë me dhomë e banje plus ndryshimi i destinacionit të apartament | 309.177 |
| | - Shtuar gjendja e likuiditeteve | 12.098 |
| | ➤ Autoveturë tip “Peugot” 03.03.2007 | 1.729.013 |
| | ➤ Apartament banimi me sip. 85,4m ² | 11.358.285 |
| 3 | Detyrimet | 8.366.916 |
| | ➤ Detyrim ndaj shoqërisë së ndërtimit (70 000 Euro) | 8.622.775 |
| | ➤ Shlyerje të kësteve të kredisë | -255.859 |
| (2-3) | Pasuritë neto | 6.441.657 |
| 4 | Shpenzime | 1.798.970 |
| | Shlyerje detyrimi ndaj kopshtit të fëmijës | 120.000 |
| | Shlyer interesat për këstet e kredive | 511.384 |
| | Shkollimi i fëmijës shkollën “(***)”, Durrës | 295.000 |
| | Shpenzime jetike sipas ILDKPKI-së | 642.857 |
| | Udhëtime jashtë vendit TIMS | 229.729 |
| | DIFERENCA | -4.024.627 |

Në analizën financiare të kryer janë mbajtur në konsideratë si më poshtë:

- ✓ Të ardhurat nga paga të subjektit të rivlerësimit;
- ✓ Arkëtimet e ndryshme dhe pagesat për blerje të regjistrueshme;
- ✓ Deklarimet e subjekti në vitin 2005 gjendje cash 600.000 lekë, nuk ka deklaruar më në asnjë vit gjendje cash të likuiditeteve dhe as në deklaratën "Vetting";
- ✓ Deklarimi i subjektit në përgjigje të pyetësorit prill 2018, se i ka shpenzuar likuiditetet e deklaruara si gjendje cash për blerjen e apartamentit;
- ✓ Janë përfshirë në përlllogaritje të ardhurat e shitjes së automjetit "Opel ASTRA", më datë 24.12.2007, me vlerë 500 000 lekë.

Sipas përlllogaritjeve financiare, Komisionit i rezultoi se në vitin 2007 subjekti nuk ka pasur të ardhurat vjetore të ligjshme të mjaftueshme për të blerë të gjitha pasuritë dhe për të kryer shpenzimet e sipërcituara, duke rezultuar me minus 4.024.627 lekë.

Subjekti i rivlerësimit me anë të ekspertit financiar ka kundërshtuar vlerën e përlllogaritur nga ana e Komisionit për detyrimet e shoqërisë së ndërtimit (70.000 euro) ose 8.622.775 lekë, kurse sipas pretendimit të subjektit duhet të ishte përfshirë i gjithë vlera e apartamentit shuma (93.940 euro) ose 11.358.258 lekë.

Trupi gjykues lidhur me pretendimin e subjektit për përfshirjen në përlllogaritje të të gjithë shumës së apartamentit, vlerëson se nuk qëndron për arsye se sikurse rezulton nga deklaratimet e dokumentacioni financiar (*mandatarkëtimet*) subjekti ka likuiduar vlerën prej 23.940 eurosh në vitin 2007, dhe se i ka mbetur detyrim shoqërisë shuma 70.000 euro (93.940 euro - 23.940 euro) të cilën e ka likuiduar në vitin 2008 me kredinë e marrë në "NBG Bank".

- Subjekti i rivlerësimit ka përfshirë në analizë financiare vlerën prej 2.000.000 lekësh si e gjendje cash në shtëpi nga shitja e pasurisë (***) Kadastrale (***) . Lidhur me përfshirjen në përlllogaritjen e të ardhurave si gjendje cash në shtëpi, Komisioni çmon, se bazuar në deklaratimet periodike dhe deklaratën "Vetting" rezulton se subjekti ka deklaruar vetëm në vitin 2005 gjendje cash 600.000 lekë, nuk ka deklaruar më në asnjë vit gjendje cash të likuiditeteve dhe as në deklaratën "Vetting".

- Gjithashtu po gjatë hetimit administrativ, subjekti ka deklaruar se i ka shpenzuar likuiditetet e deklaruara si gjendje cash për blerjen e apartamentit. Ai ka deklaruar se gjendje cash ka pasur vetëm në fund të vitit 2005 dhe në vitet e tjera, në periudhën 2003 – 2016, nuk ka pasur gjendje cash, për rrjedhojë trupi gjykues çmon se:

Subjekti nuk ka pasur të ardhurat vjetore të ligjshme të mjaftueshme për të blerë të gjitha pasuritë dhe për të kryer shpenzimet e sipërcituara, në shumën minus 4.024.627 lekë.

Viti 2010

Përlllogaritjet financiare të Komisionit lidhur më aftësitë paguese të subjektit të rivlerësimit, të pasqyruara në tabelën si më poshtë:

| ANALIZA FINANCIARE | Viti 2010 |
|--|-----------|
| Të ardhurat | 3.997.986 |
| - Paga e tij (sipas transaksioneve bankare) | 1.477.830 |
| - Nga biznesi i bashkëshortes noteri | 2.520.156 |
| Pasuritë | 1.180.629 |

| | |
|--|------------------|
| - Pakësuar gjendja e likuiditeteve në bankë | - 19.371 |
| - Blerë automjet tip. "Dailer Chrysler" | 1.200.000 |
| Detyrimet | -652.408 |
| - Shlyer kësht kredie në "NBG" (principal) | - 652.408 |
| Pasuritë neto | 1.833.037 |
| Shpenzime | 2.459.733 |
| - Shlyer interesat për kështet e kredive në "NBG" Bank | 524.409 |
| - Shlyer interesat për kështet e kredive në "ProCredit Bank" | 452.129 |
| - Shkollimi i fëmijës në shkollën "(***)" Durrës | 553.001 |
| - Shpenzime jetike | 642.857 |
| - Udhëtime jashtë vendit ²⁶ | 287.337 |
| DIFERENCA (Të ardhura minus pasuri dhe shpenzime) | - 294.784 |

Komisionit i rezultoi se subjekti nuk ka të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të blerë të gjitha pasuritë edhe për vitin 2010.

Mbi situatën financiare të rezultuar, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit të rivlerësimit pasi i rezultoi se nuk kishte të ardhura vjetore të ligjshme të mjaftueshme për të blerë të gjitha pasuritë dhe për të kryer shpenzimet e sipërcituara, në shumën *minus 294.784 lekë*.

Në parashtrimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit pretendohet se shpenzimet për dy udhëtime në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në vitin 2010, të kryera nga bashkëshortja, janë mbuluar respektivisht nga e motra dhe Dhoma Kombëtare e Noterisë, për pasojë në korrigjimet e paraqitura nga eksperti financiar vlera qëndron me *-104.614 lekë*.

Trupi gjykues, lidhur me korrigjimet e bëra nga eksperti financiar për llogari të subjektit, konstaton se pretendimi i subjektit për sponsorizimet e udhëtimeve nuk mbështeten në asnjë dokument ligjor sipas pretendimit, për pasojë nuk i konsideron të vlefshme dhe as bindëse.

Në referim të përlogaritjeve financiare dhe për sa u arsyetua më sipër, trupi gjykues çmon se subjekti nuk ka pasur të ardhura vjetore të ligjshme të mjaftueshme për të blerë të gjitha pasuritë dhe për të kryer shpenzimet e sipërcituara, në vitin 2010.

Në përfundim të çmuarjes së situatës financiare, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit rezulton me mungesë të të ardhurave të ligjshme për vitet 2004, 2007, 2010, në vlerën 6.900.259 lekë, për të justifikuar pasuritë e investuara në këto vite.

V. PROCESI I RIVLERËSIMIT TË KONTROLLIT TË FIGURËS

Drejtorja e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit kishte kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar raport për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, i deklasifikuar me vendim të KDZH-së, nr. 8, datë 08.01.2018, për subjektin e rivlerësimit në përputhje me nenin

²⁶Për udhëtimet jashtë vendit është marrë informacion nga Prokuroria e Përgjithshme 5, që konfirmon se nga ky institucion nuk ka asnjë pagesë për daljet jashtë vendit, si dhe nga Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Durrës, e cila konfirmon se nuk ka financuar dhe nuk ka kryer asnjë pagesë për shërbime apo aktivitete jashtë shtetit për arsye pune ndaj subjektit të rivlerësimit, z. Bujar Hoti.

3.2 Shpenzimet për udhëtimet jashtë vendit 7 në vitin 2010, nxjerrë nga sistemi TIMS, janë llogaritur me 138.81 lekë/euro, kursi i këmbimit të vitit 2010, marrë nga BSH për udhëtimet e poshtëshënuara

39 të ligjit nr. 84/2016, ku ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Bujar Hoti.

Nga hetimi administrativ, nuk u gjet ndonjë indice/element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

Për subjektin e rivlerësimit konstatohet se është në kushtet e përshtatshmërisë për vazhdimin e detyrës si prokuror.

VI. PROCESI I RIVLERËSIMIT TË KRITERIT ETIKO-PROFESIONAL

Grupi i Punës ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, bazuar në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Ky institucion, në përshkrimin e 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short, ka konstatuar:

Aftësitë profesionale

Analiza e gjetjeve u referohet të dhënave të nxjerra nga tri grupet e burimeve të informacionit: (i) formularit të vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga vetë subjekti; (ii) 5 dosjeve të vëzhguara të përzgjedhura me short; dhe (iii) të dhënat nga burimet arkivore në sektorin e burimeve njerëzore pranë Prokurorisë së Përgjithshme. Në funksion të qartësisë së analizës së gjetjeve, 3 akte të paraqitura nga subjekti referohen sipas radhës së paraqitur në *Pjesën I* të këtij raporti, me termat *dokumenti 1, dokumenti 2, dokumenti 3*. Ndërsa 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara, referohen sipas radhës së paraqitur në *Pjesën II* të këtij raporti, me termat *dosja 1, dosja 2, dosja 3, dosja 4 dhe dosja 5*.

1. Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Subjekti i rivlerësimit, prokurori Bujar Hoti, ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në 3 dokumentet ligjore të paraqitura prej tij dhe në 5 dosjet e vëzhguara, është konstatuar se ai identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Në disa raste, e analizon normën penale dhe procedurale penale të zbatueshme, duke e lidhur përmbajtjen e saj me akte të tjera ligjore dhe nënligjore apo me praktikën gjyqësore. Në rastin e çështjeve me natyrë procedurale përdor metodat e interpretimit për të nxjerrë thelbin e institutit procedural që është në diskutim. Ndërsa në rastin kur problematika lidhet me zbatimin e ligjit material, i kushton rëndësi çdo elementi të veprës penale për të konkluduar në kualifikimin e faktit penal, sipas normës penale. Identifikon rastet kur norma ligjore plotësohet nga akte nënligjore. Ka respektuar parashikimet ligjore dhe ato nënligjore. Aktet janë përgatitur prej tij, në respektim të dispozitave procedurale penale, por edhe të urdhrit nr. (***) datë 05.09.2003, të Prokurorit të Përgjithshëm “*Për pasqyrimin me shkrim të qëndrimit të prokurorit në seancë gjyqësore*” (dosjet 1, 2, 3, 4, 5 dhe dokumentet 1, 2, 3). Aktet e përpiluara prej tij janë ruajtur në sekretarinë e prokurorisë, në respektim të plotë të urdhrit.

Mbështetur në nenin 418, 432 e në vijim të Kodit të Procedurës Penale, si dhe në udhëzimin nr. 1, datë 14.11.2008, “*Për ushtrimin me eficiencë të së drejtës së ankimit*”, prokurori Bujar Hoti ka respektuar procedurat për ushtrimin e rekursit.

Nga vlerësimet e punës së subjektit të rivlerësimit, prokurorit Bujar Hoti, për vitet 2014, 2015 dhe 2016 të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm rezulton se:

Për vitin 2014 – subjekti i rivlerësimit, z. Bujar Hoti, është vlerësuar “*Mirë*” për aftësitë profesionale të treguara prej tij, ndërkohë që nga drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Durrës, mbështetur në treguesit vjetorë të punës, është vlerësuar “*Shumë mirë*”.

Për vitin 2015 – subjekti i rivlerësimit, z. Bujar Hoti, është vlerësuar “*Mirë*” për aftësitë profesionale të treguara prej tij, ndërkohë që nga drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Durrës, mbështetur në treguesit vjetorë të punës, është vlerësuar “*Shumë mirë*”.

Për vitin 2016 - subjekti i rivlerësimit, z. Bujar Hoti, është vlerësuar “*Mirë*” për aftësitë profesionale të treguara prej tij, ndërkohë që nga drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Durrës, mbështetur në treguesit vjetorë të punës, është vlerësuar “*Shumë mirë*”.

b) Arsyetimi ligjor

Subjekti i rivlerësimit, z. Bujar Hoti, ka aftësi në arsyetim ligjor. Aktet e arsyetuara prej tij janë të qarta dhe të kuptueshme. Ai respekton përgjithësisht rregullat e drejtshkrimit dhe përdor të gjitha karakteret e gjuhës shqipe, në funksion të qartësisë së arsyetimit të aktit të përgatitur prej tij, përveç shkronjës “ë” dhe “ç”, si dhe nuk ndiqet e njëjta logjikë në përdorimin e shkronjës kapitale për emrat e përveçëm, siç është fjala Kodi Penal apo Kodi i Procedurës Penale (dokumenti 1, 2, 3 dhe dosja 1, 2, 3, 4 dhe 5).

Konstatohet në pjesën konkluduese të dokumenteve të përgatitura nga subjekti i rivlerësimit, se në rubrikën “*Kërkojmë*”, pavarësisht se qëndrimi është për lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë, në të gjithë elementet e tij, sërish është parashtruar në një paragraf më vete fjalia: “*Lënien në fuqi të vendimit për pjesët e tjera të tij*”. Kjo fjali nënkupton lënien në fuqi të vendimit për disponimet e tjera të gjykatës, për të cilat nuk është bërë ankim. (dosja 1, 2, 3, 4, 5).

Ka korrigjime me shkrim dore të dokumentit të përgatitur me mjete kompjuterike, por përgjithësisht korrigjimet janë të justifikueshme për shkak se ndodhin te data e paraqitjes së tyre. Prokurori rezulton t’i ketë përgatitur në kohë këto akte, por për shkak të shtyrjes së seancave gjyqësore është detyruar të bëjë korrigjimin e datës të përgatitjes së konkluzioneve me ato të paraqitjes së tyre para gjykatës (*dosja 1 dhe 4*).

Në dosjen 3, konkluzionet e përgatitura nga subjekti i rivlerësimit, në dosjen gjyqësore, rezultuan të panënshkruara, por kopja e tyre e nënshkruar rregullisht u gjend e administruar në praktikën që mban Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Durrës. Këto konkluzione janë dorëzuar nga prokurori Bujar Hoti në seancë gjyqësore, pavarësisht se i pandehuri ka hequr dorë nga ankimi dhe paraqitja e tyre proceduralisht ka qenë e panevojshme.

Aktet e përpiluara prej tij konceptohen me tri pjesë. Përgjithësisht, përmbajtja e aktit është gjithëpërfshirëse dhe u jepet përgjigje çështjeve që parashtrohen për zgjidhje. Në tekstet e akteve ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur prokurori. Në nxjerrjen e konkluzioneve i kushton rëndësi analizës së normës ligjore.

Niveli i arsyetimit të akteve të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor.

Nga vlerësimet e punës së subjektit të rivlerësimit, z. Bujar Hoti, për vitet 2014, 2015 dhe 2016 të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm rezulton se:

Për vitin 2014 - subjekti i rivlerësimit, z. Bujar Hoti është vlerësuar “*Mirë*” për aftësitë profesionale të treguara prej tij, ndërkohë që nga drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Durrës, mbështetur në treguesit vjetorë të punës, është vlerësuar “*Shumë mirë*”.

Për vitin 2015 – subjekti i rivlerësimit, z. Bujar Hoti, është vlerësuar “*Mirë*” për aftësitë profesionale të treguara prej tij, ndërkohë që nga drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Durrës, mbështetur në treguesit vjetorë të punës, është vlerësuar “*Shumë mirë*”.

Për vitin 2016 – subjekti i rivlerësimit, z. Bujar Hoti, është vlerësuar “*Mirë*” për aftësitë profesionale të treguara prej tij, ndërkohë që nga drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Durrës, mbështetur në treguesit vjetorë të punës, është vlerësuar “*Shumë mirë*”.

2. Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Subjekti rivlerësimit, z. Bujar Hoti, për periudhën e rivlerësimit 08.10.2013 - 08.10.2016 ka kryer detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Durrës.

Ai ka përballuar një numër të konsiderueshëm çështjesh, të cilat rezultuan me një shifër prej 827.

Konstatohet se, subjekti i rivlerësimi, z. Bujar Hoti, për periudhën e rivlerësimit nuk ka ushtruar ndjekje penale në hetim pasi për shkak të funksionit që ka kryer, ka pasur për detyrë të përfaqësojë organin e prokurorisë në gjykim. Detyra e tij është kryer mbështetur në dispozitat procedurale penale, nenet 407 e në vijim, 424 e në vijim të Kodit të Procedurës Penale, si dhe urdhrat dhe udhëzimet e Prokurorit të Përgjithshëm.

Lidhur me efektivitetin në aspektet sasiore dhe kohore, prokurorit Bujar Hoti, subjekt rivlerësimi, për shkak të detyrës që ka kryer, analiza e të dhënave të tij bëhet në referencë të ligjit procedural penal, Kushtetutës dhe KEDNj-së, akte këto të cilat vendosin detyrimin për respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut.

Ai ka përballuar ngarkesën e punës me efikasitet.

Nga analiza e 5 (pesë) çështjeve të përzgjedhura në short, rezultoi se qëndrimi i tij ka ndodhur brenda afateve, sipas kërkesave të ligjit procedural penal.

Lidhur me kohën mesatare të arsytimit konstatohet se nga mënyra se si është organizuar dhe funksionon Prokuroria, mbështetur në parashikimet ligjore procedurale penale, nuk ka ekzistuar ndonjë afat, brenda të cilit prokurori të detyrohet të arsyetojë aktet e tij. Subjekti i rivlerësimit, konstatohet se në respektim të afateve procedurale ka paraqitur qëndrimin e tij para gjykatës dhe nuk është bërë shkak për shtyrje të pajustificuar të seancave gjyqësore.

Prokurori rezulton të arsyetojë në kohë aktet e të paraqitet para gjykatës i përgatitur. Ky fakt konstatohet në dosjen 3, kur megjithëse nuk i është dashur të paraqesë konkluzione me shkrim, për shkak se i pandehuri ka hequr dorë nga ankimi, vërehet se prokurori i ka përgatitur paraprakisht konkluzionet dhe i ka depozituar në gjykatë.

Në analizë të të dhënave të mësipërme, konstatohet se subjekti i rivlerësimit, prokurori Bujar Hoti, është eficient dhe efektiv. Në efektivitetin dhe eficiencën e veprimtarisë së tij nuk ka ndikuar ngarkesa sasiore, e cila ka qenë e lartë. Në këtë drejtim duhet evidentuar se koha është një aspekt i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor.

Nga vlerësimet e punës së subjektit të rivlerësimit, z. Bujar Hoti, për vitet 2014, 2015 dhe 2016 të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm rezulton se:

Për vitin 2014 – subjekti i rivlerësimit, z. Bujar Hoti, është vlerësuar “*Mirë*” për aftësitë organizative të treguara prej tij, ndërkohë që nga drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Durrës, mbështetur në treguesit vjetorë të punës, është vlerësuar “*Shumë mirë*”.

Për vitin 2015 – subjekti i rivlerësimit, z. Bujar Hoti, është vlerësuar “*Mirë*” për aftësitë organizative të treguara prej tij, ndërkohë që nga drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Durrës, mbështetur në treguesit vjetorë të punës, është vlerësuar “*Shumë mirë*”.

Për vitin 2016 - subjekti i rivlerësimit, z. Bujar Hoti, është vlerësuar “*Mirë*” për aftësitë organizative të treguara prej tij, ndërkohë që nga drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Durrës, mbështetur në treguesit vjetorë të punës, është vlerësuar “*Shumë mirë*”.

b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

Subjekti i rivlerësimit, z. Bujar Hoti, merr pjesë në gjykim, si palë, duke përfaqësuar Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë. Konstatohet se është i aftë profesionalisht në këtë pjesëmarrje dhe për qëndrimin që mban për çështjet në gjykim.

Subjekti i rivlerësimit, z. Bujar Hoti, nuk kryen veprime procedurale hetimore, pasi për shkak të detyrës që kryen, nuk ka ushtruar ndjekje penale si prokuror çështjeje. Ai, për shkak të funksionit si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Durrës, ka përfaqësuar Prokurorinë në Gjykatën e Apelit Durrës.

Nga vlerësimet e punës së subjektit të rivlerësimit, z. Bujar Hoti, për vitet 2014, 2015 dhe 2016 të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm rezulton se:

Për vitin 2014 - subjekti i rivlerësimit, z. Bujar Hoti, është vlerësuar “*Mirë*” për aftësitë organizative të treguara prej tij, ndërkohë që nga drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Durrës, mbështetur në treguesit vjetorë të punës, është vlerësuar “*Shumë mirë*”.

Për vitin 2015 - subjekti i rivlerësimit, z. Bujar Hoti, është vlerësuar “*Mirë*” për aftësitë organizative të treguara prej tij, ndërkohë që nga drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Durrës, mbështetur në treguesit vjetorë të punës, është vlerësuar “*Shumë mirë*”.

Për vitin 2016 - subjekti i rivlerësimit, z. Bujar Hoti, është vlerësuar “*Mirë*” për aftësitë organizative të treguara prej tij, ndërkohë që nga drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Durrës, mbështetur në treguesit vjetorë të punës, është vlerësuar “*Shumë mirë*”.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short, konstatohet se dosjet janë të administruara rregullisht, kanë listën e inventarit, materialet na njohin me faktin penal, me qëndrimin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë dhe të Apelit, disponimin e gjykatave.

3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, prokurori Bujar Hoti, konstatohet se ka filluar punë në organet e drejtësisë, fillimisht duke ushtruar funksionin e hetuesit në vitin 1986. Ai rezulton të jetë promovuar për detyrën e kryer, duke u emëruar në vitin 1991 e ka vazhduar të qëndrojë në pozicionin e kryetarit të Hetuesisë së Rrethit Kavajë, për një vit. Nga viti 1994, subjekti i rivlerësimit është emëruar si prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme dhe ka pasur

promovime të mëtejshme, duke u emëruar si drejtor hetimi në Prokurorinë e Përgjithshme në periudhën 1995 - 1996 apo drejtues i Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Durrës për periudhën shkurt 1999 - janar 2012. Aktualisht, që prej vitit 2012, vazhdon të ushtrojë detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Durrës. Nga aktet e përzgjedhura nga vetë subjekti, si dhe nga dosjet e hedhura në short, ka rezultuar se gjuha e përdorur nga subjekti i rivlerësimit në përpilimin e akteve është në përputhje me etikën profesionale të prokurorit. Nga verifikimi në sektorin e burimeve njerëzore pranë Prokurorisë së Përgjithshme, rezultoi se për periudhën e rivlerësimit tetor 2013 - tetor 2016, për subjektin e rivlerësimit, prokurorin Bujar Hoti, nuk është marrë asnjë masë disiplinore.

Nga vlerësimet e punës së subjektit të rivlerësimit, z. Bujar Hoti, për vitet 2014, 2015 dhe 2016 të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm rezulton se;

Për vitin 2014 - subjekti i rivlerësimit, z. Bujar Hoti, është vlerësuar “*Mirë*” për etikën profesionale të treguar prej tij, ndërkohë që nga drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Durrës, mbështetur në treguesit vjetorë të punës, është vlerësuar “*Shumë mirë*”.

Për vitin 2015 - subjekti i rivlerësimit, z. Bujar Hoti, është vlerësuar “*Mirë*” për etikën profesionale të treguar prej tij, ndërkohë që nga drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Durrës, mbështetur në treguesit vjetorë të punës, është vlerësuar “*Shumë mirë*”.

Për vitin 2016 - subjekti i rivlerësimit, z. Bujar Hoti, është vlerësuar “*Mirë*” për etikën profesionale të treguar prej tij, ndërkohë që nga drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Durrës, mbështetur në treguesit vjetorë të punës, është vlerësuar “*Shumë mirë*”.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, z. Bujar Hoti, dhe nga 5 dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara, nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit, z. Bujar Hoti. Në asnjë prej 5 dosjeve të vëzhguara, nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak paanësie të dokumentuar. Nga ana tjetër, asnjë prej 3 dokumenteve ligjore dhe 5 dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në 3 dokumentet ligjore dhe në aktet e 5 dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit, z. Bujar Hoti, të ketë cenuar të drejtat e palëve dhe të viktimave.

4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara, në format letër dhe në 3 dokumentet e dorëzuara prej tij, gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën e prokurorit dhe i qartë. Nga vlerësimet e punës së subjektit Bujar Hoti, për vitet 2014, 2015 dhe 2016, të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm, rezulton se:

Për vitin 2014 – subjekti Bujar Hoti është vlerësuar “*Mirë*” për aftësitë profesionale të treguara prej tij, ndërkohë që nga Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Durrës, mbështetur në treguesit vjetorë të punës është vlerësuar “*Shumë Mirë*”.

Për vitin 2015 - subjekti i rivlerësimit, z. Bujar Hoti, është vlerësuar “*Mirë*” për aftësitë e komunikimit të treguara prej tij, ndërkohë që nga drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Durrës, mbështetur në treguesit vjetorë të punës, është vlerësuar “*Shumë mirë*”.

Për vitin 2016 – subjekti i rivlerësimit, z. Bujar Hoti, është vlerësuar “*Mirë*” për aftësitë e komunikimit të treguara prej tij, ndërkohë që nga drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Durrës, mbështetur në treguesit vjetorë të punës, është vlerësuar “*Shumë mirë*”.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit të rivlerësimit, z. Bujar Hoti, për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën e Prokurorisë, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Nga vlerësimet e punës së subjektit të rivlerësimit, z. Bujar Hoti, për vitet 2014, 2015 dhe 2016, të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm, rezulton se:

Për vitin 2014 - subjekti i rivlerësimit, z. Bujar Hoti, është vlerësuar “*Mirë*” për aftësitë e komunikimit të treguara prej tij, ndërkohë që nga drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Durrës, mbështetur në treguesit vjetorë të punës, është vlerësuar “*Shumë mirë*”.

Për vitin 2015 - subjekti i rivlerësimit, z. Bujar Hoti, është vlerësuar “*Mirë*” për aftësitë e komunikimit të treguara prej tij, ndërkohë që nga drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Durrës, mbështetur në treguesit vjetorë të punës, është vlerësuar “*Shumë mirë*”.

Për vitin 2016 - subjekti i rivlerësimit, z. Bujar Hoti, është vlerësuar “*Mirë*” për aftësitë e komunikimit të treguara prej tij, ndërkohë që nga drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Durrës, mbështetur në treguesit vjetorë të punës, është vlerësuar “*Shumë mirë*”.

c) Gatishmëria për t’u angazhuar

Subjekti i rivlerësimit, në periudhën e rivlerësimit, deklaron se është angazhuar në 4 aktivitete profesionale trajnuese. Temat e këtyre aktiviteteve profesionale lidhen me transparencën në procesin gjyqësor, trajtimi i Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe karta e Bashkimit European, ndryshimet e Kodit Penal, barazia gjinore, mosdiskriminimi, etj.

Për sa më sipër, trupi gjykues, pas hetimit të raportit të Grupit të Punës, fakteve publike, nuk gjeti indice apo elemente që mund të ngrenë dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e prokurorit, për rrjedhojë ai konsiderohet “i aftë”.

VII. VLERËSIMI TËRËSOR I ÇËSHTJES

Në vlerësimin tërësor të çështjes, mbështetur në provat, faktet dhe rrethanat që Komisioni disponon për rivlerësimin e pasurisë, si dhe në vlerësim të procedurave të ndjekura nga subjekti për përfitimin e pasurive konkludohet se subjekti i rivlerësimit:

1. Ka kryer deklarin të rremë për çmimin e blerjes së pasurisë apartament banimi dhe shtesë të tij me sipërfaqe totale 187 m²;
2. Ka kryer fshehje të pasurisë/likuiditetit në vlerën 20.000 euro, si pagesë e këstit të parë, të pasurisë apartament banimi, me sip. 157m², dhe burimin e ligjshëm të tij;
3. Nuk ka deklaruar dhe ka fshehur burimin e ligjshëm të depozitës pranë bankës “NGB Bank” në vitin 2004, në vlerën 39.000 euro;
4. Nuk ka deklaruar gjendjen e likuiditeteve në vlerën 10.014 euro në fund të vitit 2004;
5. Ka dhënë pranë Komisionit deklarime të ndryshme dhe kontradiktore me realitetin e fakteve të vërtetuara nga dokumentet dhe kontratat e nënshkruara;

6. Shpenzimet e deklaruara për shumën 3.000.000 lekë për kalim pronësie dhe shumën 2.393.284 lekë për punime shtesë nuk pasqyrojnë vlerën reale të paguar për krijimin e pasurisë apartament banimi 157 m², për pasojë është çmim fiktiv i saj;
7. Nuk vërtetohet asnjë nga pagesat e deklarimeve të tij në DVP-të e viteve 2005, 2006 dhe 2007, për pasurinë shtesë apartamenti me sipërfaqe 30 m², me lidhjen e kontratës së shitblerjes në vitin 2007, për pasojë edhe në deklaratën “Vetting”;
8. Nuk ka një titull të ligjshëm për përfitimin e pasurisë toke arë, prej 4.000 m² ;
9. Fiktivitet të çmimit dhe mënyra e pagesës në kontratën e shitblerjes, me aplikimin e çmimit real të kalimit të pronësisë, për pasurinë njësi (zyrë noteriale);
10. Fiktivitet të vlerës dhe mënyrës së pagesës së ndryshimit të destinacionit dhe e ndërtimit përfundimtar të shtesës anësore me sipërfaqe 19.63 m² (24 m² në realitet);
11. Deklarim i pamjaftueshëm i pasurisë së plotë në përdorim vitit 2007, 2008, 2015 si dhe i shpenzimeve reale të kryera për ndryshim destinacioni, si dhe ka kryer punime ndërtimi pa lejen përkatëse;
12. Deklarim i pasaktë i gjendjes së pasurisë, likuiditeteve dhe detyrimeve në deklaratat e pasurisë 2007, 2008, e për pasojë në deklaratën “Vetting” të 2017-ës, për pasurinë shtëpi banimi me sipërfaqe 85.4 m²;
13. Fiktivitet të çmimit dhe mënyrës së pagesës në kontratën e shitblerjes për pasurinë shtëpi banimi me sipërfaqe 85.4 m²;
14. Fiktivitet për dy kontratat e sipërmarrjes për një dhe për dy apartamente në pallatin që ndërtonte shoqëria “(***)” sh.p.k. me investimin e shoqërisë “(***)” sh.p.k.;
15. Veprime fiktive me qëllim përfitimin e kredive bankare për pasurinë shtëpi banimi me sipërfaqe 85.4 m²;
16. Mosdeklarim i destinacionit të vërtetë të shumës 68.578 euro që mbetën nga zbritja e kostove bankare të kredisë, pas disbursimit të saj, likuiditet i deklaruar si pagesë e pasurisë shtëpi banimi me sipërfaqe 85.4 m²;
17. Ka bërë deklarime të pasakta në deklarimin vjetor të pasurisë së vitit 2012, si dhe kryer deklarime të pamjaftueshme lidhur me ndryshimin e pasurisë, si dhe të detyrimeve në DVP/2012 dhe DVP/2013, për pasojë edhe në Deklaratën e Pasurisë-“Vetting”, për pasurinë automjet “Nissan - Juke”;
18. Mosdeklarim dhe fshehje e automjetit “Opel Astra” si blerje në DVP-në e vitit 2005, për rrjedhojë mosdeklarim të burimit të ligjshëm për fitimin e automjetit “Peugot OxyGO”, në vitin 2007, për pasojë deklarim i pamjaftueshëm për burimin e ligjshëm të të ardhurave për automjetin “Nissan-Juke” në deklaratën “Vetting”;
19. Mungesë të të ardhurave me burime të ligjshme për vitet 2004, 2007, 2010, në total në vlerën 6,900,259 lekë, për justifikimin e pasurive në deklaratën “Vetting”.

Gjithashtu, trupi gjykues në vlerësim të procedurave të ndjekura nga subjekti për përfitimin e pasurive çmon se kryerja e veprimeve fiktive, nëpërmjet kontratave të përfitimit të pasurive në mënyrë të përsëritur, apo veprimeve fiktive për përfitimin e kredive bankare, përfitimi i një pasurie në rrugë të paligjshme, jo në përputhje me dispozitat ligjore, në bazë të së cilave pretendohet që të jetë përfutuar pasuria 4000 metra tokë, si dhe kryerja e punimeve pa leje, vlerësohen si sjellje përtej standardeve etike, si dhe veprime që cenojnë besimin e publikut te magjistrati, kandidat për Këshillin e Lartë të Prokurorisë.

Për rrjedhojë, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të nenit 59/1 germa “a”, të ligjit nr. 84/2016, si dhe ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë në Republikën e Shqipërisë, sipas parashikimit të nenit 61, pika 5, të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës, në nenin D, pikat 1, 3, 5, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 58, pika 1, germa “c” dhe pikave 3 dhe 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Bujar Hoti, me funksion prokuror pranë Prokurorisë së Apelit Durrës.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më datë 10.09.2018.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Lulzim Hamitaj
Kryesues

Olsi Komici
Anëtar

Brunilda Bekteshi
Relator

Sekretaria gjyqësore
Denisa Kosta